

# Jeta Arbëreshe

e-mail: [jetarbreshe@libero.it](mailto:jetarbreshe@libero.it) - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrare online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

## Përmbajtja / Sommario

### RROFTË ARBËRIA!

Zef Skjiro Maji, Gabriele Parrino faqe 2

### EDITORIALI

Drejtori faqe 3

### NGA KATUNDET ARBËRESHË

Carmine Stamile, Angelo Matrangolo, Kostandin Bellushi, Motimadh faqe 4-6

GJËMBI (D.) faqe 6-7

### FJALËKRYQI

Lucia Cardamone faqe 7

### TEKSTE, ZAKONE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË

Giuseppe Chiaffitelli, D. faqe 8-9

### QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

Emanuele zoti Giordano faqe 10-15

### SIMBJET KUJTOMI...

D. faqe 16-17

### DORËSHKRIMI ARBËRESH

Bernardo Bilotta faqe 18-19

### POEZI SHQIPE

Irena Gjoni, Klara Kodra faqe 20-21

### POEZI ARBËRESHE

Giuseppe Gallo faqe 22

### STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN ARBËRESHE

Muhamed Çitaku , Asime Feraj, Rovena Vata, Manjola Lubishtani faqe 23-31

### STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN SHQIPTARE

Artur Karasinski, Valentin Lumaj faqe 32-34

### NGA KOSOVA

Seminari XXXII Ndërkombëtar i Prishtinës faqe 35

### LIBRE E REVISTA

faqe 35

### JO VET ARBËRISHT

Pierfranco Bruni faqe 36

## Te shtatëdhjetat, ngjit ulla!

Ndodhet një strofë e bukur te një poezi e poetit turk Nazim Hikmet që ë gjithë një program i sprënxës sa t'i bëhet ballë të katërtës pjesë të gjellës që zë fill: «Gjella ngë ë lodrë, / mirre me rëndësi / po me aqë rëndësi / se te shtatëdhjetat, për shembër, / do të ngjitsh ulla / jo sa t'i qëndrojnë të bijve, / por përsë ngë do t'i kesh besë vdekjes, / me gjithë se i trëmbe, / e gjella do të mëshojë më rëndë te vallëna.»

Gjellën e kishëm adhà marrë me rëndësi shumë vjet prapa kur jui kushtuam, me gjithë se pa sukses të përhapur, Arbëreshëvet, të çilët këtë “përkushtim” e kanë rrahur e edhe sot e rrahjen te varëset e pjerra. Thom për burinë e Arbëreshëvet, kurse ndo njeri e ndëlgoi e na knderuar.

Çilin ulli do të ngjijëm te shtatëdhjetat? Nga fjalët e poetit duket se ë një ulli vetjak, personal, ngase me të vërtetë ngë mund të ngjitsh ullirin tënd te një kopsht publik ku ngë ndodhet më një thërrime dhë të lirë se u mbulua gjithë me barëra të të gjithë llojevet për një të ardhme pa të ardhme: kallamë, çikorje-bresa, sullupjesë, barëra t'erës, lulekëmborë me çançanele, hithra, driza e nidhje që me metagramë del nvidhje.

Ngë do të kishëm ngulur këmbë të ndihjem Arbëreshët të shpëtojnë gluhën e tyre dalluese. Pendim? Do t'ju kishëm kushtuar suksesit të vërtetë, atij vetjak, që vetëm gluha italiane mund të japënj. Mëkat!

Por, le të jesë, që do t'i bëjëm nani? Te shtatëdhjetat të vemi përpara tuke ngjitur ulla me kryefortësi.

Zef Skjiro Maji

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

## A SETTANT'ANNI, PIANTA ULIVI! -

C'è una bella strofa in una poesia del poeta turco Nazim Hikmet che è tutto un programma speranzoso per affrontare l'incipiente quarta età: «La vita non è uno scherzo, / prendila sul serio / ma sul serio a tal punto / che a settant'anni, ad esempio, / pianterai degli ulivi / non perché restino ai tuoi figli, / ma perché non crederai alla morte, / pur temendola, / e la vita peserà di più sulla bilancia.»

La vita già l'avevamo presa sul serio tanti anni fa quando ci siamo dedicati, pur senza successo clamoroso, agli Arbëreshë, che di questa “dedicazione” se ne sono sbattuti e se ne sbattono i ciondoli riversi. Dico della massa degli Arbëreshë, perché invece qualcuno ha capito e ci ha onorato.

Quale ulivo piantare a settant'anni? Dalle parole del poeta pare essere un ulivo personale, privato, perché certo non puoi piantare il tuo ulivo in un giardino pubblico dove non c'è più uno spicchio di spazio invaso da erbe di tutti i generi di un futuro senza futuro: stoppie, cicorie, erbe di vento, campanule ciancianellanti, ortiche, rovi e l'indivia anagrammata in invidia.

Avremmo dovuto non insistere ad aiutare gli Arbëreshë a salvare la loro lingua identitaria. Pentimento? Avremmo dovuto dedicarci al successo vero, quello personale, che solo la lingua italiana è in grado di dare. Peccato!

Alla faccia, però; che c'è da fare ormai? A settant'anni continuare a piantare ulivi caparbiamente.

## Anakrostik

## Puthja e Flamurit

Puthjëm Flamurin, o Arbëreshë  
Urtësi do t'kemi ndë jetën mbarë  
Thellë te shekujt kemi rrënjët e lirisë  
Janë flakëruar mbë zjarrin të Ilirisë  
Arbëreshë, Arbërorë e Shqiptarë  
Ej k'të thritje ju bën  
Flasjëm arbërisht kudo që jemi  
Lartësojëm embrin që kemi  
Atdhetarë ndë jetën mbarë  
Mirësinë të kemi të pandarë  
Udhën dritje e zëmbren zjarr  
Ringjalljen do të përjetojëm  
Idhealisht bashkonemi  
Tjetërsisht pajtonemi

Gabriele Parrino

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

IL BACIO DELLA BANDIERA - Bacciamo la Bandiera, o Albanesi d'Italia / Saggiamente avremo ogni di / Profonde nei secoli abbiamo radici di libertà / Che ardono nel fuoco Illirico / Albanesi d'Italia, Albanesi di Grecia e Albanesi / Sì, questo invito vi faccio / Parliamo Albanese dovunque siamo / Magnifichiamo il nome che portiamo / Patrioti in ogni dove / D'avere sensibilità grande / Strada lucente e cuore ardente / La rinascita vogliamo perpetuare / Idealmente uniamoci / Senz'altro conciamoci.

## ...Te gjashtëdhjetekatërtat, ndërkaq, bëmi vëra nd'ujë!

Jeta Arbëreshe del me pak faqe, këtë herë, sepse Arbëreshët duan të prehen. Aq me të shkruar sa me të djovasur. E u, për të parën herë ka dymbëdhjetë vjet, s'i lodha shumë me mail e me telefon. Gjë muaj prëhjeje i bëjën mirë Arbëreshëvet.

Mbanj mendë kur Jeta Arbëreshe dil nga muaj, në formë kartje, e shumë s'bëjën mbë herë të djovasjin numrin e janarit, se... errëni numri i fjavarit! Të tjerë mote! Të tjera fuqi!

T'vësh përpara është rëndë, t'qëndrosh është edhe më keq. E kjo është hera e t'ecurit, jo të mbeturit.

Jeta Arbëreshe është mirë t'rronjë. Sepse Gjuhën Arbëreshe e shkruan, jo vet sa e kujton, jo vet sa i këndon një "trisajon" kur i merr malli. E shkruan ashtu si folet, katund për katund, në formën më popullore si në formën më artistike. Kjo rivistë është folë e vatër, palestër e skollë, universitet e akademi. Rron për t'i bënë martri gjallërisë s'Gjuhës Arbëreshe.

Zëmra e çdo Populli është Gjuha. Zëmra e Arbëreshëvet është Gjuha Arbëreshe: jo ajo ç'gjegjmi ka buza e të tjerëvet, po ajo çë folmi na, me buzën tonë. Gjuha është si petku: është jotja, e vet'hesë sate; si petku është yti, i vet'hesë sate. Aq gjuhën, sa petkun, s'ke t'i ndash me mosnjeri. T'i lanë prindt e tu, si dhuratë: e ti menatë ja lë bilvet të tu. Të gjuhës e t'petkut mund t'bësh atë ç'do: vlejën aq sa ti i vlerëson. Një gjuhë, ndëse e folën, vlen për tij e tu bil, e të nderon ku do (e me kë) e folen; ndëse s'e folën, s'vlen faregjë. Një petk, ndëse s'e rëmon, me motin s'vlen faregjë. Gjuha, si petku, do dashur mirë. Gjuhën ke t'e folsh, petkun ke t'e shërbesh; gjuha do xënë mirë, petku do punuar; gjuha do folur bilvet, petku do koprisur; gjuha do shkruar, petku do mbjellë; gjuha do folur mirë, petku do skalitur; gjuha do studiuar, petku do korrë; gjuha do ruajtur, petku do rrethuar.

Herehere më duket se kjo puna ime kulturore i gjet punës së atyre ambientalistëve që bëjën sa mundjën për të xarrisur njetër herë nd'ujë ato balena çë buartin udhën e shpisë, e janë po të spavisjën mbi zallin e detit. Po janë të sigurtë, ata ambientalistë, se janë e i bëjën një t'mirë atyre pishqve, o mos këta zgjedhtin vet t'spavisjën mbi ata zalle? E u, kur mbi këtë rivistë i tëhelq vesht atyre Arbëreshëve që qellen si Lëtinj, jam i sigurtë se jam e i bëj një t'mirë? S'ish më mirë t'i lëja të venë për fatin e tyre?

**Drejtori**

...A SESSANTAQUATTRO ANNI, INTANTO, FACCIAMO BUCHI NELL'ACQUA! -

Jeta Arbëreshe esce con poche pagine, questa volta, perchè gli Arbëreshë vogliono riposarsi. Sia a scrivere che a leggere. E io, per la prima volta da dodici anni, non li ho molto assillati con e-mail e telefono. Alcuni mesi di riposo fanno bene agli Arbëreshë.

Ricordo quando Jeta Arbëreshe usciva mensile, in forma cartacea, e molti non facevano in tempo a leggere il numero di gennaio, che...arrivava il numero di febbraio! Altri tempi! Altre forze!

Andare avanti è pesante, fermarsi è ancora peggio. E questo è il momento di camminare, non di sostare.

Jeta Arbëreshe è bene che viva. Perchè la Lingua Arbëreshe la scrive, non solo la ricorda, non solo le canta un "trisajon" quando le viene la voglia. La scrive come si parla, paese per paese, nella forma più popolare come nella forma più artistica. Questa rivista è nido e focolare, palestra e scuola, università e accademia. Vive per testimoniare la vitalità della Lingua Arbëreshe.

Il Cuore di ogni Popolo è la Lingua. Il Cuore degli Arbëreshë è la Lingua Arbëreshe: non quella che sentiamo dalla bocca degli altri, ma quella che parliamo noi, con la nostra bocca. La Lingua è come la proprietà: è tua, personale; come la proprietà è tua, personale. Tanto la lingua quanto la proprietà, non la devi dividere con nessuno. Te le hanno lasciate i tuoi genitori, in dono; e tu domani gliele lasci ai tuoi figli. Della lingua e della proprietà puoi fare ciò che vuoi: valgono tanto quanto tu le fai valere. Una lingua, se la parli, ha valore per te e per i tuoi figli, e ti fa onore dovunque (e con chiunque) la parli; se non la parli, non vale niente. Un campo, se non lo zappi, col tempo non vale niente. La Lingua, come la proprietà, va amata. La Lingua la devi parlare, la proprietà va lavorata; la lingua va imparata bene, il campo va arato; la lingua va parlata ai figli, il campo va concimato; la lingua va scritta, il campo va seminato; la lingua va parlata bene, il campo va sarchiato; la lingua va studiata, il campo va mietuto; la lingua va difesa, la proprietà va recintata.

A volte mi sembra che questo mio lavoro culturale assomigli al lavoro di quegli ecologisti che fanno di tutto per trascinare nuovamente in acqua quelle balene che hanno perso la strada di casa e stanno per morire sulla spiaggia del mare. Ma sono sicuri, quegli ecologisti, di fare un bene a quei pesci, o invece questi hanno scelto da soli di morire su quelle spiagge?

E io, - quando su questa rivista tiro le orecchie a quegli Arbëreshë che si comportano da Italiani - sono davvero sicuro di far loro del bene?

Non sarebbe meglio abbandonarli al loro destino?

## Manifestimë ndë Qanë ndë 4 e muajit të Shën Mitrit

**Carmine Stamile**

ka Shën Japku (Cs)

Nikoqirja të Qanës për 4 e muajit të Shën Mitrit ka organixuar një manifestim i thieshtë e shumë i ndiejtur sa të mendonj rëndësin të ushtarve e gjithë ata që diqëtin ndë të dia luftat. Tek manifestini që u bë ndë qishë, tuke thënur një meshë, muartin pjesë nxënërat të skollës filllore e të skollës të mesëme, zotërinj e shumë gjindë nga katundi. Ish atje edhe zoti Tade Wojtarowicz, baskë me të shoqen e me të birin Dhuar. Zoti Tadë, cilit krietari i Bashkis, arkitët Zepa Rizzo, i dha një dokument të kuitimit, ka lerë ndë Pollònie e gjatë të fundit të luftës botërore, edhe i vogël, qe marr nga tedhestrat, bashkë me gjërit e tij, e qe qelltur ngë Xhermànie.

### Vangjeli + Fjalor

(të zotit Emanuele Giordano)

**€uro 30**

Pas lirimit, zoti Tadë mbeti ndë Ingëlltër e nëng vate më ndë Pollònie. Ndë Ingëlltër njohu një grua nga Qana, cilën pas martoi, e kështu u bë edhe arbëresh. Nga ki martesë u lenë di fumij: Dhuardi e Lleonardi, cilët kanë frekuentuar skollën filllore të Qanës, ndë vitrat 1975 – 1980. U qeva mjeshtri i tire, cilëve i mbësova edhe gjuhën arbëreshe. Për mua qe një ngashërim i madh kur pe nxënin Dhuard pas katërdhjetë vjet me të jatin. Pata një hare e madhe kur pe se Dhuardi, tuke mbetur Rromë , nëng harroi gjuhën arbëreshe e do të ja mbësonj edhe bijave të tij.

### MANIFESTAZIONE A CERZETO PER IL 4 NOVEMBRE

L'amministrazione comunale di Cerzeto, il 4 novembre, ha organizzato una manifestazione semplice, ma molto suggestiva, per evidenziare l'importanza delle Forze Armate e per ricordare i caduti nelle due guerre. Alla manifestazione che si è svolta in chiesa, con la celebrazione di una messa, hanno partecipato gli alunni delle scuole elementari e medie, autorità civili e religiose e molti cittadini. Era presente alla cerimonia anche il signor Tadeus Wojtarowicz, accompagnato dalla moglie e dal figlio Edoardo. Il signor Tadeus, al quale il sindaco architetto Giuseppe Rizzo ha consegnato un attestato alla memoria, è di origine polacca e durante l'ultimo conflitto mondiale, nonostante fosse piccolo, fu deportato dai tedeschi, insieme ai suoi familiari, e rinchiuso nei campi di sterminio. Dopo la liberazione, da parte degli inglesi, il sig. Tadeus è rimasto in Inghilterra e non è ritornato più in Polonia. In Inghilterra ha conosciuto una donna di Cerzeto, che poi ha sposato, e così è diventato anche un nostro concittadino. Da questo matrimonio sono nati due figli: Edoardo e Leonardo i quali hanno frequentato le scuole elementari di Cerzeto-Cavallerizzo negli anni 1975-1980. Io sono stato il loro maestro, sia per quanto riguarda le materie curricolari e sia per quanto riguarda l'insegnamento della lingua arbëreshe. Per me è stata una grande emozione rivedere l'alunno Edoardo, dopo quasi quarant'anni, e conoscere anche il padre. Mi ha fatto molto piacere che Edoardo, pur vivendo a Roma, non ha dimenticato la lingua arbëreshe appresa molti anni fa ed è felice di insegnarla alle figlie.

# Jeta Arbëreshe

Semestrata online di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtëmuajore online e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”, Purçill / Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**

Drejtori, Redaksi e Administratë / Direzione, Redazione,

Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)

Tel. (+39) 0981-32539 / e-mail: [jetarbreshe@libero.it](mailto:jetarbreshe@libero.it)

sito internet - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

**Ku dërgohen e dhurohen turesët /** Versamenti e Donazioni: Credito Cooperativo Mediocrati, cod.Iban IT 22 H 07062 70850 000000116918, intestato a: Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina/Purçill (Cs-Italia)

**Regjistrim /** Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

**Artikuj, Dorëshkrime e Fotografij, edhe ndëse s’botohen, nëng priren prapë /** Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

**Drejtorja nëng është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar /** La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati

**Gjithë të drejtat të rezervuara /** Tutti i diritti riservati

## Një Betlem i vendit tonë i vogël e i gjallë : Fallkunarë

Jemi afër festës që lefet Zoti Krisht, ma që ëshët kjo festë ? Drita sikur të ish ditë, shumë gjindë që anangasen për të bjejnë dhuratën më të bukur, o të stolisëjën prrarin e grazhdin që duket më shumë ? O është të lerit e Krishtit, moment që mbafet mend e parkaleset ? Me siguri hipoteza e dytë, e kështu largu ka zbukurimet e shkëlqimet e festës, Fallkunarë, një katund i vogël arbëresh, ditin gjashtëmbëdhjetë të shëndreut, do të bëfët për të parin herë “ Grazhda arbëreshe e gjall “. Tek ky proxhet marrëjin pjesë skollët për Fëmijët Parësor e Dytësor të Fallkunarës edhe të Torremexit që bëjnë pjesë të Institutit i Zonës të Shën Luçido, ku janë të zënë si protagonistra njëqind e tetë skollëlë. Po shurbesi më i bukur e kësaj Grazhdie është se do të ambientofët ndër gjitonit të Fallkunarës edhe ata e ato të vegjël që marrëjin pjesë do të jenë me të veshurat arbëreshe. Ndër ca udhë e ndër ca katoqe të vjetëra do të jenë ambjentuar ca mjeshtëri si : ai që bënë djathin, ai që bënë shporta, ai që bënë këpucë, ai që shurben hekurin, ai që bënë bukë e ndryshe ftigë që bëfshin një herë. Do të jenë vajza ngarkuar me shkarpa mbi kurriz si bëjin ato gra arbëreshe një herë. Realizimi i kësaj shfaqje do t’i jap prindëvet, gjirivet e djemvet edhe atyre që vijin e shofjin, mundësin të admirojnë bukurit e Fallkunarës. Edhe kështu mund vlersofët një kulturë që është e humbin karakteristiket e saj edhe të mësojnë kështu historinë dhe zakonat arbëreshe. Në një atmosferë e ngroftë e me gazin e farën e djemvet, patjetir, ngë birni atën që vjen me thënë virteta se Krishti lefet, ai që na shpëton:

**Angelo Matrangelo**

ka Firmoza(Cs)

**IL PRESEPE VIVENTE IN UNA PICCOLA BETLEMME NOSTRANA: FALCONARA ALBANESE** - Siamo prossimi alla festività del Natale 2013, ma il Natale cos’è ? Luminarie a giorno, migliaia di persone freneticamente in corsa contro il tempo per acquistare il più bel regalo, o preparare l’albero e il presepe più appariscente ? O Natale è la nascita di Cristo, momento di riflessione, di rievocazione e preghiera ? Sicuro della seconda ipotesi e lontano dai bagliori delle decorazioni natalizie, nel piccolo borgo di Falconara Albanese, quest’anno, il 16 dicembre, verrà rappresentata la 1° edizione del “ Presepe vivente arbëresh “. Questo progetto coinvolgerà le scuole dell’Infanzia, Primaria e Secondaria di Falconara Albanese e Torremezzo di Falconara facenti parte dell’Istituto Comprensivo di San Lucido e vedranno coinvolti 108 alunni. Nota dominante di questo Presepe è l’ambientazione nelle suggestive gijtonie di Falconara e i piccoli protagonisti vestiti con costumi arbëresh. Nelle stradine si snoderà il percorso del Presepe e nei vecchi magazzini verranno ambientati alcuni mestieri quali : il casaro, il cestaio, il calzolaio, il fabbro, il fornaio e varie altre attività artigianali. Ci saranno anche ragazze con fascine sulla schiena come usavano le donne arbëreshë in un passato non tanto lontano. La realizzazione di questo Presepe vivente permetterà a genitori, parenti dei ragazzi e visitatori di ammirare le bellezze e il paesaggio suggestivo di Falconara Albanese. Inoltre attraverso questo piccolo ma importante evento si cercherà di valorizzare e consolidare una cultura che sta perdendo i suoi tratti fondamentali e poter far conoscere la storia e le tradizioni arbëreshë. In un’atmosfera calda di giovani sorrisi, certamente, non si perderà il senso del Natale, la nascita del Salvatore.

### Jeta Arbëreshe

(12 vjet: 2002 - 2013)

76 numra, 1.562 faqe

Gjuhë, Letërsi, Histori, Folklor e Lajme ka Arbëria e ka Bota Shqiptare

**500 euro**

Gjithë 76 numrat në DVD

**50 euro**

Tel. (+39) 0981-32539 - Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina (Cs - Italia)



## Peshkopi vizitarti Qishen e Pllatënit

**Kostandin Bellushi**

ka Pllatani (Cs)

Të diallan ndër 28 të Llunarit 2013, ka ora 9.30, Peshkopi i ri i Eparhisë së Ungrës, Imzot Oliverio Donato, erdh e vizitarti, për t' parën herë si Peshkop, Famullinë e Pllatënit "Shën Janj Pagëzor". Gjindja e katundit, bashkë me Fangjiskun sindk, me zotin Ariton, ç' a mbitarti, dhe me ca t' bukura arbëresha, t' veshura me stulitë llambëdhori (Rosaria, Maria, Mariasilvia, Viola e Francesca), a priti ka qaca madhë plot me haré dhe i thë: "Mirë se na erdha, Peshkopi inë!", e psana i uroj shëndetë për shumë vjet (Is pollà eti, despota). Psana gjithë bashkë van m' klishë për meshan. Me Peshkopin erdhtin dhe sekretari i tij, zoti Sergio; zoti Pjetër, protosinçëlli i Eparhisë, dhe seminaristi Giampiero. Imzot Donato erdh për t' bëni misionan e tij ç' është ajò t' shtinj krishterëtë t' jen zëmërmiri dhe t' rrojan si vllëzar; t' ken mallin për tën Zon dhe për njerzit; t' ken kuraxh t' ven përpara me hjen e t'Inzotit dhe për t' ken më besë, sprënx, prej Atij, dhe dashurí njeri me jetrin. Pas ç' u farnua mesha, ç' kle kënduar dhe me korin e klishës së Pllatënit, drejtuar shumë mirë ka mjeshtri Diodati Vincenzo, peshkopi, bashkë me zotin Ariton dhe me djakonin Kostandini, vat e gjet smurët e katundit për t'i thoj, si vlla, nj' fjalë a mirë dhe për t'i ndith t' lezohshin psimet e tira. Si mbrëmnat, kur ish e ikni, a përshëndetëtim gjithë kutjend se mbet'tim mirë me atë edhë sepse kle vartet nj' ditë a bukur dhe a bekuar.

## GJËMBI

### Dihet, po s' bëhet

Riti bixantin, te Qishat Arbëreshe, do nderuar. Ngadita. E tërësisht.

a) **Dyert e Qishës Bixantine** janë dy: e vogla dhe e madhja. E vogla hapet ngadita: ka ajo hijen e dalen gjithë, të vdekur e të gjallë; e si mbaron Mesha o të t' tjera cerimoni liturgjike, dera vogël mbullihet. E madhja hapet rrallë, shumë rrallë.

b) **Kur hihet mbë Qishë**, i krishteri bixantin ulen kriet e bën kriqë; nëng ulen (ose bën gjestin t' ulënj) gjürin, si lëtinjtë.

c) **Burrat ulen nd' fund t' Qishs**, veç ka gratë; gratë ulen përpara, veç ka burrat. Te Priçsjunat

## Dashurí

**Motimadh / M. G. Miracco**

ka Shën Sofia (Cs)

Ishi një mot, ishin të bukur mote, pjot dashurí, shumë mot prap, kur bëghej rrubulljon me jeten e poezinë, tue marr trene, bir; e ato fjal çë së gjegjen "ec me shndetë", të thën ka ndonjë maçarele te praku ndonjë derje. "Mos më harro".

E më mangan, më mangon ai sjet te pondi, nën vidhit, lletorina ç' i bij trumbes kur nisej e kur arrvonij; e këtë më vjen nxe fjala "Dashurí".

Një fjalë e vetem, një fjalë na përgjegjet "Dashurí". Pse birami? Ajo çë sërresmi mallë, ajo muhjeqa, ai shaban, çë na llaven trut, diglisen gjellen, çë na lidhën me një të ruajtur i magjepsur, "Dashurí".

Të fala, miku im, të shkruanj sot se çova nuse, e jeta ime gëzon.

E di sa të qeshura kur djovasen këto fjalë, ç' do ki ka u, sa her gjegja këto fjalë, njëter bir çë iken e vete pas "Dashurisë": u kam ndë duar vet ilza të çara e fucka sapuni.

Të potisa me mall si një lule, sa t' rritçe e shëndoshtë, po jetri rrii te praku deres e priti, të muari e të qelli me të; kur të pien pse, ti përgjegje: "Dashurí".

Marrmi ajer me duar, doj të mirrja ajer ndë duar: së mirret ajer me duar, kush na vodh të bukuren vashez, kush na kalloi dialin gadhjar?

Bëlica, ajo çë kemi përpara, na rriten si lule ndë këto loxhët, fanmiri ganjuni çë she kutëndicen çë jeta na vjon te trimria, pa e vat kërkuar gjetskë.

Gjenden udha çë të thon "Ecmi", gjenden ajre çë të pëshjtjellen; dishtim me fuqi e mall boten ton, dishtim me fuqi e mall rrënjat tona, doja t' ikja ka këjo pecenderi, doja të shkatërrihça ka këto rrënjë.

Po gjella së më lërën: më ghelq, si ghelqmi rolen me llacin, tue i dhën rrenx sa t' mos dalë jashtë udhes.

(Processioni), burrat venë përpara, pas Kriqes, gjithë bashkë; gratë vijen prapa, pas Ikonës s' Shëjtit. Veç e veç. Ashtu te Lipet: burrat përpara, pas Kriqes; gratë prapa, pas t' vdekurit.

d) **Tendat e Ikonostazit** janë të bënura për t' hapen e për t' mbëllihen. Kur duhet. Jo vet "kur na e ka ënda" o "kur e mbami mendë".

e) **Livant e Livansërja** (Incenso e Incensiere) përdoren (si usano) ngaherë ç' duhet: jo nj' herë "ëh"

## Gjëj këto fjalë

Gjëj këto fjalë.

Me Fjalët çë qindronjen bëhen tri fjalë.

Çoji.

**Lucia Cardamone**

ka Shën Sofia (Cs)

TH	GJ	I	R	G	H	B	A	R	K	Ë	S	I	Z	Ë	D
LL	U	P	Ë	R	U	K	Ë	L	P	J	Ë	N	Z	E	B
U	J	A	S	Y	N	R	R	L	E	SH	E	V	LL	E	R
T	B	M	Ë	K	D	A	O	E	M	I	Q	U	TH	S	I
E	Ë	A	T	Ë	Ë	H	D	T	R	U	T	RR	Ë	E	NJ
J	RR	V	SH	Z	O	RR	Ë	K	E	A	SH	Ë	M	Z	E
S	U	E	GJ	U	H	Ë	SH	T	P	X	I	D	B	E	Z
Ë	L	A	SH	B	M	U	LL	SH	I	E	GJ	N	E	L	T
Ë	Z	E	LL	U	M	H	GJ	A	K	R	Y	Ë	R	O	E
G	O	F	V	I	S	R	Ë	K	B	K	N	GJ	I	RR	T

ASHT  
BALLË  
BARK  
BËRRUL  
BRINJEZ  
BUZË  
DELL  
DORË  
GOF  
GRYKË  
GJAK  
GJËNDËRR  
GJIR  
GJISHT

GJU  
GJUHË  
HUNDË  
KËMBË  
KËRSI  
KËSIZË  
KRAH  
KRYE  
LESH  
LËKURË  
MULLSHI  
MULLEZ  
MUSHKRI  
PJËNZ

QIME  
RROLEZ  
SJETULL  
SY  
SHALË  
SHPATULL  
TRU  
THËMBER  
THUA  
VESH  
VESHEL  
XERK  
ZORRË

### GJËMBI

e tri herë “jo”.

f) **Këndimi** arbëresh e grek (e jo të djovasurit lëtisht bla-bla-bla) është një karakteristikë e qishavet bixantine. Po Këndimet duan xënë mirë e kënduar mirë. Sipas muzikës bixantine.

g) **Kalimafi**, me tünken e me supränen, bën pjesë me t’veshurat e priftit bixantin: mbrënda Qishës përdoret (si usa) ngaherë, gjatë cerimonivet liturgjike.

(1 - është më)

(D.)

## Vangjeli sipas Arbreshvet t'Mashqitit

Kur isha i vogël, tatëmadhi më rrëfij Vangjelin si a dij ai, o si ja kishën rrëfyer.

Atëherë Zoti Krisht ma dhëshipulit vej për katunda ndër vendat e Pallestinës, ish një bukur mot, ajri i ngrohtë, frij një erë a lehtë e a butë, dialli nga qialli i kalthër llambarisij e dritsoj sheshat e malat, dherat e vreshtat: dukij drej Parrajsi që të ngjallij shpirtin! Ecjan pra dhëshipulit mbë këmbë, për karrara ndër të mbjelat ari, kur panë, ndë një vreshtë, një vajzë të bukur që shërbej e këndoje a gëzuar tura shkurtuar e ture lidhur vëllastara ma shumë shpejtësi e pa lodhur kurrë.

U mbetëtin tura vënur kufi këtë kopilë që shërbej ma hare e lehtësi, gëzohshin kaq sa ja dëftuan Krishtit: “Njo, Zot, - i thanë - si shërben mirë e shpejt kjo vajzë. Kloft bakuar ai burrë që a ve kuror!”. Po nëng shkua shumë e panë ndën një lis, ta hjeja pranë njëj kroj, një trim i shtruar për së glati e derdhur përdhe që flij ma gjumë të rëndë si qeni Bakut (qeni i njohur nga gjithë për që flij natë e ditë!). Si a panë shën Pjetri e shën Janji piajtin Zotin: Zoti Mjeshtëri, ti që ke fjala të vërtetjet, thuajna, si do të jetë sa kush bënë kaq kaq e kush fara fara. Ajo vajzë shërben kaq e ki këtu plotë ma fuqi e shëndetësi e derdhur për dhe, fle si qeni i vrarë. Zoti Krishti, ma sytë a përmistë e tura ruajtur përdhësi i përgjegjii:” Ma të vërtetë ma të vërtetë ju thom, sa këta dij kë t’martohen për që për nga një që shërbenë duhat njetër që fle; nga një që mbushan buzjelan ma verë do të jetë njetër që a mbrazan, turrestë që dorëngushti bën kaq për të i mbhedh, dorëhapti i shprishan, kush a rrumon vreshtan e kush a vjel!”. Po dhëshipulit nëng ishan adhe përgatitur për të diligojan fjalat a Krishtit e adhe u isha shumë i vogël për të diligoja mirë. Po nani që u rrita e u bëra plak, mbesova shumë shërbisa, diligova se ndë një njeri ha e pi pa shërbëtirë ndë një vend i këtij dheu, duhat sa ndë njetër vend, llargu o pranë, kë t’jetë njetër që shërbenë e rri pa ngrenë.

Ashtu veta gjella, ashtu veta shekulli!

Kush vdes uri e derdhan djersit tura sherbyer e kush ha, pi, rri e le pordha.

Fjala të urta të Zoti Krisht! Jo, jo, ndlenmi e më ndleft Krisht! Këto fjale janë vetëm fjalët pa urtësi të tatëmadhit, një arbresh i vërtetë që njihij shumë mirë burra e .....gra.

**Giuseppe Chiaffitelli**

ka Mashqiti (Pz)

**IL VANGELO SECONDO GLI ARBRESH DI MASCHITO** - Quando ero piccolo il nonno mi raccontava il vangelo come lui lo sapeva e come glielo avevano raccontato.

Allora il Signore con i discepoli andava per i villaggi e le contrade della Palestina, era bel tempo, l'aria era tiepida, soffiava un venticello leggero e dolce, il sole nel cielo azzurro splendeva ed inondava di luce pianure e montagne, campi e vigneti: sembrava davvero un paradiso che ti rinvivava lo spirito!

Camminavano quindi i discepoli a piedi tra le messi biondegianti, quando videro, in una vigna, una leggiadra giovane che lavorava e cantava allegramente, accorciando e legando i tralci con molta sveltezza senza mai stancarsi. Si fermarono guardando con attenzione questa ragazza che lavorava con gioia ed agilità e si rallegravano tanto da mostrarla a Cristo: “Ecco, Signore, gli dissero, come lavora bene e con alacrità questa giovane. Beato quell'uomo che la sposerà!”.

Ma non trascorse molto tempo che videro sotto un albero, all'ombra vicino ad una fontana, un giovane steso in lungo e gettato per terra che dormiva con sonno profondo come il cane di Bacco (cane noto a tutti perchè dormiva sempre, notte e giorno). Come lo videro, san Pietro e san Giovanni dissero: “Signor Maestro, tu che hai parole di verità, dicci, come possa essere che chi tanto tanto e chi niente niente? Quella giovine fa tanto e costui, pieno di forza e salute, gettato a terra dorme come un cane morto”. Il Signore con gli occhi abbassati e guardando a terra rispose loro: “In verità, in verità vi dico che quei due si sposeranno perchè per ognuno che lavora occorre un altro che dorme, per ognuno che riempie il fiasco di vino ci sia un altro che lo svuota; i soldi, che l'avaro fa tanto per raccogliere, il prodigo li sperpera; chi zappa la vigna e chi vendemmia!”.

Ma i discepoli non erano ancora pronti per capire le parole di Cristo e anche io ero troppo piccolo per capirle bene. Ma adesso che son cresciuto e diventato vecchio, ho imparato molte cose; ho capito che se una persona mangia e beve senza lavorare in un luogo di questo mondo, occorre che in un altro posto lontano o vicino ci sia un altro che lavori senza mangiare. Così va la vita, così va il mondo! Chi muore di fame e getta il sudore per lavorare e chi mangia, beve, riposa e fa scorregge.

Parole sagge del Signore. No, no, perdonatemi, e mi perdoni Cristo: queste parole sono solamente le parole non sagge di nonno: un vero arbresh che conosceva molto bene uomini e... donne.



## Kalimera ' Shën Vasilit

Shëjti Vasil  
ë për me dashur,  
se t' mirit ç' bëri  
ë të pamasur;  
si drita diellit  
çë mirë na bën,  
ashtu prej Qiellit  
Shëjti na gzon.

Si Shëjti u qell,  
ndëse do t' dini,  
hapni Vangjelin  
e mbjatu e shini:  
gjindjen dritsonej  
shëjtra të bëshshin  
dhe t' liqt butsonej  
mirith të qellshin.

Mandaj ka gjith  
i dashur ish,  
lik nëng dij t' bënej  
si Zoti Krisht:  
Vasilin tonë  
Inzot bekoi  
edhe Shën Mëria  
atë nderoi.

Ariant atij  
nëng pat' tin ç' bëjen  
pse fjalet ' tij  
besen lart ngrëjen:  
gjith ata t' nëmur  
ku si butthohej  
ikjen e gjella  
keq i thartohej.

Dojen t' e vrisjen  
retqit mandaj,  
po ëmrin Valenti  
s' mund shkruanej  
maj:  
ahiera drithma  
Valentin zù,  
po fare ndrroi  
të tijet tru.

Inzot e smurti  
të tijen grua,  
këtu Valenti  
Shëjtit ju trua:

ki parkalesi  
Krishtin jatrua  
e shpejt e shoqja  
e tër u shrua.

Me gjith ktë t' mir,  
ki parandor  
fare nëng shuajti  
të tijen for:  
Shëjtin nëng rejti,  
me Arin mbajti;  
buar shpejt luften  
e armiqt e dogjtin.

Vllezer, nì xeni  
se kush lufton  
me shëjtërin  
aì s' e gzon:  
e ndë ktë jet  
rron i mallkuar,  
prana te jetra  
është i dënuar.

Mandaj ju thom:  
Lutmi Tënzot,  
ashtu e gzomi  
atë ngamòt;  
si Shën Vasil  
mbi dhe e shkomi,  
pra ndë Parrajsit  
Tënzòn trashgòmi.

O Shën Vasil,  
ti s' na do t' bjerr,  
Tij na të truhemi  
ka Inzot pjerr;  
tek na nëng mundmi,  
o Shëjt, na ndih:  
armiqt e tanë  
ti gjith na shprish!

O Shën Vasil,  
katundit zot,  
mbaj sit mbi ne  
ngamot si sot:  
kështu gjillimi  
na të nderuar,  
me Tij pra jemi  
të lartësuar.

## Kalimera ' Shën Mërisë

Shën Mëria, tue kënduar,  
merr të Birin e e qëllon,  
e m' i thot, mbë të djepuar,  
"Fjēj, oj bir, edhe bën on.

Fjēj, o i dashur, e mos qaj:  
rri ndë prëhrit e mos bën vaj. **(Ritorn.)**

O sa i bukur ti më jé,  
o sa i hjeshtëm, biri im!  
Syu it më jep hare,  
më mbjon shpirtin me gëzim.

Djal i vogël, Zot i math,  
Më çë t' shoh, më fort të dua!  
Rri te gjiri im dicàth,  
mos shërtò, ndë më do mua.

Perëndi e njarì i vërtet,  
pir të llavurin t' mkatruar  
dishe t' vije te kjo jet,  
ku do t' jesh aq i helmuar!

O da helme do t' duronj,  
sa lavoma te ki gjì:  
thom se ahiera s' mund të rronj,  
kur të t' shoh tea to hjidhì!

Ka gjith shokt do t' jesh i lënë,  
ka të gjith, e djelm e pjeq:  
shitur, puthut dhe i zën  
ti do t' jesh ka Judha i keq.

Po mos qaj, o Biri im,  
mëma jote t' përgëzon.  
Fjēj nani, pa sherëtim,  
Fjēj, o bir, edhe bën on!"

\* Kjo Kalimere këndohet Purçill tek novenat e Natallet e te dita e festës; po vjen ka Hora e Arbëreshëve, aq si tekst sa si muzikë. E mbjoth **Zef Skirò** (1865-1927), e gjëmi tek vepra e tij "Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia, (Stab.tip.Luigi Pierro e figlio, Napoli 1923, është kënga LXXXII e pjesës "Canti Sacri", faqe 222-223). Redacjona e Purçillit ndërron mbrej asaj të Skiroit: i mungojën 2 strofa (e pesta dhe e tetëta) e pra gjuha qe e adaptuar (nga papas E.Giordano, prift i Purçillit për 63 vjet) së folmes arbëreshe të Purçillit.

\* Autori është papas **Bernardo Bilotta** (1843-1918); teksti qe i muzikuar ka stërnipi i tij, papas Emanuele Giordano. Shën Vasil është shëjti patron/pajtor i Purçillit, e festa e tij bie të paren e janarit. Kjo Kalimerë këndohet Purçill, gjatë novenavet t' Shëjtit dhe te dita e festës.

## Paràklisis / Parkalesje

**Prifti:** I bekuar Perëndia ynë për gjithmonë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.

(pruar arbërisht) **zoti Emanuele Giordano**

ka Frasnita (Cs)

**Populli / Kori:** Amin.

## Psalmi 142

O Zot, gjegj të falurit tim, mirr vesh lutjen time, pas vërtetës sate, gjegjmë pas drejtësisë sate  
Dhe mos hyr mbë gjykim me shërbëtorin tënd, se mosnjë i gjallë mund të dalë i drejtë përpara teje  
Se armiku rrahu shpirtin tim, përuli jetën time për dheu  
Më vu të rri ndër vende t'errët si të vdekurit ç'ka mot; prandaj m'e zu hji dhia shpirtin tim, e zëmra ime u taraks përmbrenda meje  
Kujtova ditët e shkuara, mendova gjithë të bënat e tua, tue menduar mbi të bënat e duarvet të tua  
Ndëjta duart e mia drej teje, shpirti im ka etë për tij si dhë i thatë  
Shpejt gjegjmë, o Zot, m'u zu fryma  
Mos prir mënjatë faqen tënde prej meje, se mos t'i gjas atyre që zbyryten ndë varrt  
Bën të gjegjën lipisinë tënde që menatet, se u tek ti pata shpresë.  
Bën të njoh udhën tek cila kam t'ecën, se tek ti ngrëjta shpirtin tim  
Shpëtomë nga armiqtë e mi, o Zot, tek ti u erdha e u fsheha: mësomë të bën vëlimën tënde, se ti je Perëndia im  
Shpirti yt i mirë le të m'udhëronjë mbi dhë të drejtë; për ëmrin tënd, o Zot, ngjallmë  
Në drejtësinë tënde nxir shpirtin tim nga ngushtica, dhe në lipisinë tënde asgjësò armiqtë e mi  
E humb gjithë ata që helmojnë shpirtin tim, se unë jam shërbëtori yt.

**Prifti (këndon):** Perëndi ë' Zoti dhe u buthtua neve, i bekuar ai që vjen në ëmrin e Zotit.

(shih: E.G.:Himne Liturgjike..., faqe130)

**Populli:** Perëndi ë' Zoti.....

**Prifti:** Lavdëroni Zotin dhe thërritni ëmrin e tij të shëjtë.

**Populli:** Perëndi ë' Zoti.....

**Prifti:** Gjithë gjindjat më rrethuan, po me ëmrin e Zotit u ruajta prej atyrëve.

**Populli:** Perëndi ë' Zoti.....

**Prifti:** Ky është shërbes që bëri Zoti dhe është i mërakulluarshëm përpara syvet tanë.

**Populli:** Perëndi ë' Zoti.....

## Tropare

O mbëkatarë e të mjerë, vrapojmi ngaherë te Mëma e Perëndisë, e me dhëmbje përulemi me tërë zëmren e thërresmi: O Mbretëreshë, ndihna, tundu e lipisna neve; se jemi po të biremi për shumicën e mbëkatëvet. Mos largò shërbëtorët e tu të gënjyer, se Tij të kemi si shpresën tonë të vetmen.

*Lavdi Atit.....*

(Tropari i Shëjtit të Qishës)

*Nani e përherë.....*

Kurrë nëng pushomi na të padenjë të lajmërojmi fuqinë tënde, o Mëma e Perëndisë; se ndëse nëng ishe Ti të ndërmjetoje, kush na shpëtonej nga aq rreziqe? Kush na kish ruajtur njera nani të pafajshëm? Nëng largohemi ka Ti, o Rregjëreshë, se Ti shpëton ngaherë shërbëtorët e tu ka çdo vrer.

## Psalmi 50

Kij lipisi për mua, o Perëndi, sipas lipisisë sate të madhe, dhe, sipas dhëmbshurivët të tua të shumta, shuajë paudhësinë time.

Lajmë nga paudhësia ime edhe pastromë nga mëkati im.

Se unë e njoh paudhësinë time dhe mëkati im është kurdoherë përpara meje.

Bëra mëkat kundër tij vetëm dhe përpara teje bëra të ligën; kështu që ti je i drejtë ndër fjalët e tua e i kthjellët

## Paràklisis / Parkalesje

ndër gjykimet e tu.

Se, njo, ndër të liga qeva i piksur e ndër mëkata më leu mëma ime.

Se, njo, ti do mirë të vërtetën: të fshehurat e të panjohurat e urtësisë sate ti m'i zbulove.

Lýejmë me hisop e u do të pastrohem, lajmë e u do të bëhem më i bardhë se bora.

Bën të gjegjën gjëzim e haré, eshtrat e mi të përlur do të gëzohen.

Prir mënjatë faqen tënde nga mëkatat e mia edhe shuaji gjithë paudhësitë e mia.

Stis një zëmër të pastër tek u, o Perëndi, dhë përtërir përmbrenda meje një shpirt të drejtë.

Mos më resht llarg prej faqes sate e mos nxir prej meje Shpirtin tënd të Shëjtë.

Jipmë prapë gëzimin e shpëtimit tënd e fortëromë me shpirt madhështor.

Do t'i mësonj të paligjëvet udhët e tua dhe të pabesët do të priren tek ti.

Shpëtomë nga shprishja e gjakut, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim, e gjuha ime do të lavdëronjë me gëzim drejtësinë tënde.

O Zot, hapi buzët e mia e goja ime do të rrëfyenjë lavdinë tënde.

Se ndëse ti kishe dashur një therore, u t'e kisha dhënë, po tij hollokaustet s'të pëlqejën.

Therore ndaj Perëndisë është një shpirt i përdhëmbur: një zëmër të përdhëmbur dhe të përlur Perëndia nëng do t'e shanjë.

Bëni mirë, o Zot, Sionës, sipas mirëdashjes sate, dhe le të rindërtohen muret e Jerusalamit.

Ahiera do të të pëlqejën therore drejtësisje, dhurata e hollokauste.

Ahiera do të të sjellën viçra mbi alltarin tënd.

(Kanoni i përbërë ka Shën Janji Damasqinò)

### Kënga I

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona*

I shtypur ka shumë ngasje, shtrohem tek Ti, e të lipënj shpëtim, o Mëma e Fjalës e Virgjëreshë shpëtomë nga fatkeqësitë e nga rreziqet.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona*

Sulmet e pësimevet më tërbojën e më mblojën shpirtin me shumë dëshpërim, kthjellomë, o Virgjëreshë e tërëkulluar, me qetësinë e perëndishme të t'yt Biri.

*Lavdi Atit.....*

O Virgjëreshë, që leve shpëtimtarin e Perëndi unë të thërres se t'jem i liru nga kundërshtitë, se prirem tek Ti e ngrënj shpirtin e mendjen time.

*Nani e përherë.....*

O e vetmja Mëmë e Perëndisë, denjò kurmin tim të sëmurë e shpirtin tim me një vizitë tënde të Perëndishme dhe të e me providencën tënde si Mëmë e dhëmbshur i Atij që është i dhëmbshur.

### Kënga III

*O Hyjlindse e tërëshëjtë...*

O Virgjëreshë, Mëma e Perëndisë, unë të emëronj mbrojtëse e përkrahje të jetës sime o e vetmja dhe e denja e çdo lëndije, burim i çdo mirësisje, përkrahje e besimtarevet, udhëtomë tek porti yt.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

Të lutem, O Virgjëreshë, të largosh ka u turbullimin tim shpirtëror, dhe zierjen e ligështimit tim. Ti me të vërtetë, o Nuse e Perëndisë, leve Krishtin Prëngjipën e Paqës, o e vetmja e Tërëdëlirë.

*Lavdi Atit.....*

Ti që leve Mirëbërësin, shkak i çdo mirësisje, bën të mburonjë në të gjithë pasuria e mirësivët të tua me të vërtetë. Ti mundën çdogjë, o shumë e lumtura, që leve Krishtin e tërëfuqishëm.

*Nani e përherë.....*

**Paràklisis / Parkalesje**

Ndihmë, o Virgjëreshë, se jam i mundur nga sëmundje të ashpra dhe nga pësime të fortë se, me të vertetë, Tij të njoh, o e tërëdëlirë, si thesar të pandërprerë të pambaruar i shërimevet.

Shpëtò shërbëtorët e tu nga çdo rrezik, o Mëmë e Perëndisë, se të gjithë priremi tek Ti, pas Perëndisë, si mur i pashkatërrueshëm e mbrojtje.

O Hyjlindse e denjë e çdo lëvdije, prir sytë e tu të butë mbi sëmundjen e rëndë të kurmit tim e shërò lavomat e shpirtit tim.

(Lutje e lypje):

**Populli:** Lipisi, o Zot. (3 herë).

**Kathizm**

O Ndërmjetse e fuqishme e mur i pamposhtur, burim i lipisisë, strehim i jetës, na paprëhje të thërresmi, o Zonjë, Mëmë e Perëndisë, tundu e lirona nga rreziqet, Ti, e vetmja, që jep ndihmë me shpejtësi.

**Kënga IV**

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

Qetësò, o Nuse e Perëndishme, tërbimin e pësimevet të mi e turbullirën e mbëkatëvet të mi, Ti që leve Zotin, krijuesin e jetës.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

Ti që linde lipisjarin e shpëtimtarin e save të himnojën, hapmë mua që të lutem avsin e lipisisë sate.

*Lavdi Atit.....*

Na që të njohmi si Mëmën e Perëndisë, o e tërëdëlirë, tue marr pjesë ndër dhurtirat e tua, të këndojmi një himn falënderimi.

*Nani e përherë.....*

Do të jemi të liruar nga çdo fatkeqësi, na që të kemi Tij, shpresë, përkrahje e ndihmë të patundshme të shpëtimin tonë, o e denjë e çdo lëvdije.

**Kënga V**

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

Mblo me harë zëmrën time, o e Papërlyer, Ti që leve shkakun e gëzimit e më dhe gëzimin tënd të pastër.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

Lirona nga rreziqet, o Mëma e dëlirë e Perëndisë, Ti që leve Shpëtimin e përjetshëm e Paqën që përshkon çdo mendje.

*Lavdi Atit.....*

Shprish mjegullën e ftesavet të mia, o Nuse e Perëndisë, me rrezat e shkëlqimit tënd, Ti që leve dritën e perëndishme dhe të përjetshme.

*Nani e përherë.....*

Shërò, o e dëlirë, sëmundjen e shkaktuar nga pasjonat e mia; denjomë me një vizitë tënde e jipmë shërimin me ndërmjetimin tënd.

**Kënga VI**

*O Hyjlindse e tërëshëjtë.....*

O Virgjëreshë, lut Zotin të më lironjë nga ligësia e armiqtvet, Zotin e Birin tënd, që dorëzoi vetëhenë e tij vdekjes e shpëtòi nga kalbësia e ka vdekja naturën time të ratur për shkak të kalbësirës.

## Paràklisis / Parkalesje

*O Hyjllindse e tërëshjtë.....*

O Virgjëreshë, Të njoh si përkrahse e ruajtje shumë të sigurtë të jetës sime, se Ti largon shumicën e ngasjevet e shprishën sulmet e djelvet e u të lutem ngaherë të më lirosh nga pasjonat e mia korruptuese.

*Lavdi Atit.....*

Na të kemi Tij, O Virgjëreshë, si mur shpëtues e shpëtim të përgjithshëm të shpirtit tanë, ngushëllim të shtrëngesat e gëzojmi gjithmonë të shkëlqimi yt. Edhe nani, o Zonjë, shpëtona nga pasjonat e nga rreziqet.

*Nani e përherë.....*

Lëngonj nani te një shtrat sëmundjesh e s'ka shërim për kurmin tim, po Ti, që leve shpëtimtarin e jetës e Perëndi, e shëruesin e sëmundjevet, të lutem, o lipisjare, ngrëjmë nga kalbësimi i lëngimevet.

Lirò shërbëtorët e tu nga çdo rrezik, o Mëma e Perëndisë, sepse na të gjithë drejtohem tek Ti, pas Perëndisë, si mur i padërmuarshëm e përkrahje.

O e papërlyer, që me një fjalë, në mënyrë të pathënshme, ndër ditët e sprasme, leve Fjalën Perëndi, lute me ndërmjetimin tënd mëmësor.

**(Këtù prifti bën Litanië, si është përshkruar)**

**Populli:** Lipisi, o Zot. (3 herë)

### Shkurtore

O ndihmë e pamposhtur e të Krishterëvet, ndërmjetim i pandërprerë ndaj Krijuesit, mos i resht lutjet tona mbëkatarësh, por eja shpejt si e mirë, edhe neve na ndihmò, që të thërresmi me besë. O Hyjllindse, mos mënò të ndërmjetosh për ne edhe shpejt shpëtona, Ti që ndihmon gjithëmonë ata që të nderojnë.

*(shih: E.G.:Himne Liturgjike..., faqe174)*

**Varg / Proqimënon**

*Do të kujtonj ëmrin tënd gjeneratë mbë gjeneratë*

(2 herë).

Gjegj, o Bilë, vërë re e ndëje veshin tënd e harrò popullin tënd e shpinë e t'yt Eti, e mbreti do të dëshironjë bukurinë tënde

*Do të kujtonj ëmrin tënd.....*

**Prifti:** Edhe sa t'vlerësohemi të gjegjmi Vangjelin e Shëjtë, Zotit Perëndisë tonë le t'i lutemi

**Populli:** Lipisi, o Zot. (3 herë).

**Prifti:** Urtësi, drejt! Le të gjegjmi Vangjelin e Shëjtë. Paqë të gjithve.

**Populli:** Edhe shpirtit tënd.

**Prifti:** Këndim ka Vangjeli i shëjtë pas Lukës. Le të vëmi re.

**Populli:** Lavdi Tij, o Zot, lavdi Tij.

(Lc 1,39-49,56)

Ndër ato ditë Maria u nis e vate në malt dhe erru shpejt te një horë e Judhës. Si hyri te shpia e Zaharisë, tēfali Elizabetën. Sanënga Elizabeta gjegji të falurit e Maries, këcei djali te gjiri i saj. Elizabeta u mblua me Shpirt të Shëjtë e thërriti fort: "E bekuar ti ndër gratë dhe e bekuar pema e gjirit tënd! Dhe ka më ngau mua se e jëma e Zotit tim të vinij tek u? Njo, sanënga zëri i tēfalurit tënd erru ndër veshët e mi, djali këcei për gëzim te gjiri im. Dhe e bekuar Ti që pate besë, se do të vërtetohen shërbiset që të tha Zoti". Ahiera Maria tha: "Shpirti im madhëron Zotin dhe shpirti im gëzohet në Perëndinë, Shpëtimtarin tim, sepse ruajt postësinë e shërbëtores së tij. Soteparët gjithë gjeneratat do të më thërresën të bekuar. Sepse shërbise të mëdha bëri tek u i Tërëfuqishmi, dhe i Shëjtë është ëmri i Tij". Maria ndënji bashkë me 'të ndonj tre muaj, pëstaj u pruar te shpia 'saj.



**Paràklisis / Parkalesje**

**Populli:** Lavdi Tij, o Zot, lavdi Tij

*Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjt*

shpirtravet të atyreve që me dashuri i besojën mbrojtjes sate të perëndishme.

**Kënga VIII**

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona.*

O Virgjëreshë, mos shaj ata që thërresën ndihmën tënde e të himnojën e të lartësojnë, o e delirë, ndër shekullit.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona.*

O Virgjëreshë, derth pasurinë e shërimevet mbi sa me besim himnojën e lartësojnë lindjen tënde të pathënshe.

*Lavdi Atit.....*

O Virgjëreshë, shërò sëmundjet e shpirtit tim e dhëmbjet e kurmit tim, se të mund të të lavdëronj, o e Hirplotë.

*Nani e përherë.....*

Resht sulmet e ngasjevet e vrullin e pasjonavet, o Virgjëreshë, ashtu që të himnojme në jetët e jetëvet.

**Kënga IX**

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona.*

Mos shaj, o Virgjëreshë, rreket e lotëvet të mia, Ti që leve Krishtin, që ka gjithë fytyrat fshijti gjithë lotët.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona.*

O Virgjëreshë, mbjò me gëzim zëmren time e dërmò hjdhërimin që më bëri mbëkati, Ti që pate plotësimin e haresë.

*O Hyjlindse e tërëshëjtë, shpëtona.*

Ji Ti, o Virgjëreshë, port, ruajtje, mur i patundshëm, strehim, përkrahje e harë e save priren tek Ti.

*Lavdi Atit.....*

Dritësò, o Virgjëreshë, me rrezat e dritës sate, e llargò errësiren e paditurisë, ata që me poni të thërresën Mëmë të Perëndisë.

*Nani e përherë.....*

Shëromë, o Virgjëreshë, e ndërromë mbë shëndetë të keqen, sepse u lingoñj, i përulur te një vend pësimi.

**(Prifti livanisen altarit, ikonat e popullin, ndërsa këndohet)**

Të ka hje me të vertetë të të lumërojmë Tij Hyjlindse, gjithmonë të lumturën dhe të përbidëlirën e Mëmën e Perëndisë tonë. Më të nderuarën se Hjeruvimet dhe më të lavdëruaren pa përqsasje se Serafimet, që pa u përlyer linde Fjalën Perëndi, me të vertetë Hyjlindësen, Tij të madhërojmë.

*(shih: E.G.:Himne Liturgjike..., faqe166)*

Nderojmë me himne Atë që është më e lartë se qieltë, më e dëlirë se shkëlqimet e djellit, Atë që na liroi ka mallkimi, Rregjërëshën e jetës.

Për shkak të mbëkatëvet të mi të shumtë, është sëmurë kurmi im e është sëmurë edhe shpirti im; mbanë teje vinj, që je pjotë hir, o shpresë e të dëshpëruarvet, ndihmë.

O zonjë, Mëma e Shpëtimtarit, mbjith kërkesat e shërbëtorëvet të tu të padenjë, e ndermjetò ka Ai që u le ka Ti: O Rregjërësja e jetës, ji ndërmjëtja jonë.

Më gëzim e zell, Tij, o Mëmë e Perëndisë, këndomi këtë himn, me Parërendesin e me shëjtrat të gjithë ndërmjetò, o Mëma e Perëndisë, se të kihet lipisì për ne.

Të pafjalë le të bëhen buzët e atyre të pabesve, që nëng përulen përpara ikonës sate udhëzuese, e ngjyer nga Luka Apostull i Shëjtë.

**Paràklisis / Parkalesje****(Kètù Prifti vete e përnderon ikonën e Shën Mërisë)**

O ju aradhe ëngjëllore të gjitha, o Ti parëndës i Zotit, o ju dymbëdhjetë Apostul e Shëjtra të gjithë, ndermjetoni bashkë me Mëmën e Perëndisë se të mund shpëtohem.

Shëjt Perëndi.....Trini e tërëshëjtë.....Lavdi Atit.....Nani e përherë.....Ati ynë.....

**Prifti:** Se jotja është rregjëria fuqia e lavdia, e Atit e Birit edhe e Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.

**Populli:** Amin.

**(Kètù këndohet Përlëshorja e Shëjtit të ditës, me Theotoqion.  
Ndëse nëng ka shëjt të kremtuar, këndohen këta Tropare pendimi)**

Ki lipisi për né, o Zot, ki lipisi për ne, sepse jemi pa një mbrojtje;

Tij, si Zoti ynë, na mbëkatarë ngrëjmi këtë lutje: kij lipisi për ne.

*Lavdi Atit.....*

O Zot, kij lipisi për ne, se na kemi shpresuar tek Ti, mos u zëmëro me ne as u kujtò për padrejtësitë tona, po prir edhe nani, o lipisjar, syun tënd mbi ne e lirona nga armiqtë tanë; Ti je me të vertetë Perëndia ynë e na populli yt, të gjithë të bënë ka duart e tua e kemi thërritëtur ëmrin tënd.

*Nani e përherë.....*

Hapna neve derën e lipsisë sate, o e bekuara Mëmë e Perëndisë, se na, ndëse shpresojmë tek Ti, nëng qëndrojmi të gënjyer, me anen tënde do të jemi të liruar ka fatkeqësitë, se Ti je shpëtimi i populvet të krishterë.

*(Këtù prifti bën lypje ndryshe per kë bëhet paraklisi)*

**Populli :** Lipisi, o Zot (3 herë).

**Përlëshimi**

(Populli puthën ikonën e Shën Mërisë, ndërsa këndohet)

Ti, o e Mirë, ndihen të gjithë ata që prirën me besë nën dorën tënde të fuqishme, se si mbëkatarë që jemi të vënë përposh ka një shumicë mbëkatarësh, ndër rreziqet e ndër dhëmbjet, nëng kemi njetër ndërmjetëse të përherëshme mbanë Perëndisë. O Mëmë e të lartit Perëndi, prandaj përpara teje të përulemi. Lirò nga çdo fatkeqësi shërbëtorët e tu.

Je Ti gëzimi i të sëmurevet të gjithë, ndihmja e të shtypurvet, velje e të uriturvet, ngushëllimi i të pastrehuarvet, vizitorja e të sëmurevet, strehimi, e ndihmja e të sëmurevet, shpëtuesja e të paprindërvet, O Mëma e të Lartit Perëndi, anangàsua, o e Papërlyer, të lutemi, shpëtò shërbëtorët e tu.

Mblith, o Zonjë, kërkesat e shërbëtorëvet të tu e lirona nga çdo nevojë e pësim.

Gjithë shpresën time e vë tek Ti, o Mëmë e Perëndisë. Ruajmë nën mbulesën tënde.

**ose këta Himne të Apostulvet:**

Të mbledhur këtù, o Apostul, ka kufinjte e dheut, në sheshin e Gjetsemanit, varrosni kurmin tim; e Ti Biri e Perëndia im, mirre shpirtin tim.

O ëmbëlsi e ëngjëlvet, gëzim i hidhëruarvet, o perkrahëse e të krishterëvet, ndihmë e liromë nga pësime të përjetshme.

Të kam Tij si ndërmjetëse ndaj shumë Lipisjarit Perëndi; mos i shaj të bënë e mia përpara Engjelvet, të lutem, o Virgjëreshë, ndihmë.

O turrë e tërë rrethuar me arë, qytet i rrethuar me dymbëdhjetë mure, Thron ka shkeptën djelli altar i Mbretit; mërakulli e pakuptuarshme! Si po i jep sisë Tynzoti?

**Prifti:** Me uratat e Etervet tanë të shëjtë, o Zoti Jisù Krisht, Perëndia ynë, kij lipisi për né.

**Populli:** Amin.

**Achille Parapugna****(1855-1883)**

U le Purçill/Ejanina, ka Xhambatista e Dila Arkuri. Te Kollexhi i Shën Ndrianit, në Shën Mitër, ku studioi, qe shumë i dashur mirë ka Jeronim De Rada e qe mik me t'biltë e tij, mësegjithë me Sepen. U shkrua tek Universiteti i Napulit, per të bëhej avukat, po shëndeta s'e la t'mbaronej studimet. I zoti i gjuhës arbëreshe, shkruajti poezi arbërisht e lëtisht; të tjera poezi lëtire i pruar arbërisht. Një dorëshkrim i titulluar *Kangjele* kish t'gjëndej ndër libret e Bibliotekës së zotit Vincenzo Selvaggi, ndër duart e të nipravet ka Purçilli. Këtu botomi një poezi të tij.

**Këngë malli \***

Kopilez e bukur ndë zëmer më hire,  
me tijnja kopile, kët zëmer e more:  
ndër lot e ndër helme kët zëmer e vure,  
e njohe se zjarrin që kish s'e buar fare;  
po ruaje një herez me buzen mbë gas,  
kopile, kët zëmer që katrish m'u pjas,  
e shërome ti.

Oj!, prirem mbë t'ëmbel, kopile, ata si,  
lavomja ksaj zëmer shërohet njenjë!  
Pse ndë mes t'helmit, ndër lotzit e le,  
kët zëmer lavosur, që t'ulet mbë gju?  
Kopile, kopile, për sa t'desha mir,  
ka helmi ku m'vure, kopile, më nxir,  
e ëmblëz nani.

T'amarta, t'kirkova, t'pushtova me mall,  
Pse ti nd'kët zëmer shkilqen më se nj'ill.  
Ti vashez e bukur, ti faqe si moll,  
tek zëmra më hire, më hire si hell!  
Po thùajem nj'herez se ti më do mir,  
po thuajm, e ka helmi, ku m'vure, më nxir,  
kët zëmer shërò.

O!, foka, kopile, më ruan lipisjare:  
të tundi, të shkundi kjo zë helmore!  
Po ngà te kjo zëmer, ku halez u vure:  
je imja, je imja, je e zëmres tek hire.  
Oh! Eja nd'kta krah ti me buzen mbë gas,  
të lipen kjo zëmrez, që mua m'u pjas,  
që mir të do.

\* Kjo poezi gjëndet tek "tezza e llàures" e drejtorit **Agostino Giordano** (*Poesia popolare a Frascineto ed Ejanina*), Universiteti i Romës, viti akademik 1973-74, faqe 705.

**Giuseppe De Rada****(1852-1883)**

U le Maq, fracjonë e Shën Mitrit (Cs), bir i Jeronimit De Rada e i Maddalena Melicchio-s. Studioi më parë te Kollexhi i Shën Mitrit e pra Kurëlanë. Adhë trim, shkruajti një Gramatikë e gjuhës arbereshe, që i jati Jeronimi i botoi, në Firenze, te viti 1871. Mik i ngushtë i poetit Akill Parapunja ka Purçilli, shkruajti shumë vjershe, poezi e sonete, që i biri ' tij Xhillormi De Rada, te viti 1865, bashkë me ndihmën e zotit Vincenzo Selvaggi, prift i Vakaricit. Vdiq i ri, kish shkuar ka pak tridhjetat. Këtu botomi "sonetin 11", të titulluar M.T.K. \*

**M.T.K.**

E bukur, vash, më jé sa mos njeri;  
e bukur më se qielli pa ré;  
e bukur kur më tuned e pjono hjé;  
e bukur më se të thom un nëng e di.

E bukur kur më tuned e kur më rri;  
e bukur kurna gjë më ruan me ré;  
e bukurònd që do më nget ndë dhé,  
e që do më ruan, mixore, me ata sy!

E bukur pra mbi gjith më je kur më fjet  
e kur më qeshen me ata sy të zezë,  
që thjellen qiellin kur ka trubullì.

E bukur je më shumë se një Perëndi,  
E të bukur tend aq ndë noré m'u dhez  
Sa një cik as më lë të zë rrëçet.

(*Suferé – me 30 dit Mars 1874*)

\***Giuseppe De Rada**, *Opere*, a cura di Girolamo De Rada junior e Vincenzo Selvaggi, Editrice Mit, Cosenza 1965, pag.264.

**Djovas, Shkarkò, Shprish  
Jeta Arbëreshe**

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

**Francesco Crispi Glaviano****(1852-1933)**

Frangjisk Crispi Glaviano (1852-1933), nga Palaci Adrian (Pa). Nip i krieministrit talljan Francesco Crispi-t, nxënës te Seminari Arbëresh i Palermit; poet e studiues i folklorit, mbjoth përralla e poezi popullore arbëreshe, e la shumë poezi të pabotuara e tek e folmja e katundit tij, nani e bjerrë. Dica poezi të tija panë dritën mbi rivistat Kombi e Arbri i ri. Vepra e tij më e madhe është poemi “Mbi malin e truntafilevet”: e la dorëshkrim, por papasi prof. Matteo Sciambra e botoi te viti 1963. Një vepër mbi traditat e zakonet e katundit, e përshkuar nga një mall i math për Mëmëdheun mbatanë detit.

**Kangjeli III \***

Po na priremi mbi malin,  
mbi këtë mal truntafilesh,  
ku edhe vijin atëloshet,  
te ki muaji i korrikut,  
tue fashkursur, tue klar,  
çë te Fusha draprin lijn,  
çë këta brinja e gorrromia  
e këta shqëmbe të krafosme,  
si majmune e pilatore  
e si dhi, si kazamitra,  
gjith ngipin të shkretosmit  
me të madh dishirim  
këtu ku ndodhemi na sot,  
të Bërrorza, mbi këtë çuk,  
edhe ngipin grat tona  
çë te gjiri mbain fshehur  
zjarr'i madh çë i digjë zëmrat,  
e te theket gjak i gjall  
çë gadhì derdur kishin  
për të vlezërit mbar rropi  
nënë flamurat e turkut.

Ma noi ritorniamo sul monte, / su questo monte delle  
rose, / ove veniano pure gli avi, / in questo mese della  
mietitura, / affannosi e piangenti / i quail  
abbandonavano la falce nella Fuscìa / che a quest'erte  
precipitose / a queste balze informi, / quail bertucce e  
daini / quail capre e cervi / gl'infelici tutti ascendevano  
/ cin grande desiderio! / Qui dove noi oggi siamo / nella  
etta della Birroreza / ancor salvano le nostre donne / le  
quail in seno teneano ascoso / / fuoco grande che loro  
bruciava i cuori / e nelle vene vivido sangue / che

**Nicolò Chetta****(1741-1803)**

U le Kuntisë (Pa). Nxënës e pra Rektor i Kollexhit Grek-arbëresh i Palermit. Prift bixantin, qe i pari rektor çë u vesh si prifrat bixantinët, me mjekër e musteqe; te Kopela e Seminarit stisi të shëjtën Vimë sipas ritit bixantin dhe Seminaristëvet i mësoi të këndoje Meshen greke. Veprat e tija, të lëna gjithë në dorëshkrim, u botuan pas vdekjes së tij: La colonia greco-albanese di Mezzojuso (1909), Nuove notizie sulla fondazione di Mezzojuso (1912); Tesoro di notizie su' Macedoni (2002); Nga Testi letterari in albanese (edicionë kritike e Matteo Mandalà-së, Collana Albanistica 22, S.Sciascia editore, Palermo 2004;

**Liriche varie, nr. XII, faqe 176 ,vv.1-18):**

Fjalz' e mirë u prū, e u tha prë krushqī,  
unaza u dhanë, e palë më stolī,

kezë, sqep, vet, bres, linjë, se t'zotronjë  
nusenë se te ngjeshnjën si një zonjë.

Dhëndri petk muar, kashë, haromë, e dhera,  
ju burua val, mjalt, kripa, buka e vera.

Krushq, kuntra, ndrikulla, gjerī, e prindra  
motra, vlezër, kunet, miq qindra, qindra,

mblidhenë burra. Grā, vasha e trima,  
rritet nderja, gëzimi, frima, e sqima.

Dhëndurra na levokset plo harë,  
gjith na stoliset me shisha e me hjë.

Prosopī sumbla sumbla, plo bubuqe,  
Përzihen faq e bardhë, faqe kuqe.(...)

Isht nusja një hënë, isht dhëndri një diell.  
Ajo për sī, dī ils nën bāll siell,

Shteku fëqollje, kript mundafshi janë  
Xinura e vetulla fil'ari kanë. (...)

sarebbero state pronte a versare / a pro' dei fratelli tenuti  
schiavi / sotto le insigne del Turco.

\* **Qendra Ndërkombëtare për Studimet Shqiptare – Palermo** (a cura di ), *Francesco Crispi Glaviano, Mbi malin e Truntafilevet / Sul monte delle rose* – testo e traduzione dell'autore; introduzione, commento e note di Matteo Sciambra, Scuola Tipografica Salesiana, Palermo 1963, pp.4-5; Cfr. anche: **Aiadi / Associazione Insegnanti Albanesi d'Italia** (a cura di), *Alfabetizzazione Arbëreshe*, Ed.Il Capitello, Torino 2000.

**Tringëllimet e Binard Bilotës (1843-1918)**

*Tringëllimi/Soneti është, patjetër, një ndër format poetike më të përdorura ka Binard Bilota. E më të shumtët e tyre janë të pabotuar. Këta 8 tringëllime,, që sot shohën dritën për të parën herë, gjënden te një fletore (format 14x20,5, 110 faqe, të panomruara ka*

transkriptoi **Agostino Giordano**  
ka Purçilli (Cs)

*Autori, e pa përkthim në gjuhë italiane). Një shkon dhe e tërë Vepra Letrare e B.Bilotes, e botuara e e pabotuara, do të ketë Katalogun e saj.*

**Vjershëth mbi Prillin e simbjët**

Popo sã Prilli i simbjët është për mua  
i skërdnirtur e i tert! Oreks s'më jë  
të thom e të këndonj që do u dua,  
se të thom e këndonj mua bën hjë...

Të shkruenj e të këndonj kam një sarua!...  
Prisja (shkuer dimri keq me t'ngrit vorë  
e bër e shira shëm sã jeta u mbjua  
me dëme) të trazohsha e t'ndihsha i lë,

të këndonja me oreks, me çër si shëg  
të kuqe e si rroz pishje i shëndosht;  
prisja të këndonja, dha si dëg mbë dëg

zogu këndon tue vatur lart e posht  
mallin të çonj ka rri e e pret t'e djëg  
si fjtur te hilmari, ku malli është.

(4 t'prillit 1891)

**Luse prë të mër të gjithve**

Dōj të birja një dhëmb po të mund bëhsha  
si më këndnej të bëhsha t'bënja mër!...  
Kështu tue bën u mër vo më gëzovsha  
E pa nj'dhëmb shkonja gjellen të fanmër...

Tue rāt me at kaloqe doja t'prëshsha  
mbi gjith të liqt që s'duan njarin māj mër.  
Prana që i ngurja gjith, doja t'furnohsha  
e vdekjen puthnja më se mëm të mër.

Se t'errëja të ngurja njerzit zes,  
si naten dielli nguren, donja u drit  
të shtinja ka gjith anat pre një pres.

Donja u të mund bëhsha si më ndit  
më dreq ka jeta u t'reshtja kë ndëles  
së pret të kët ka Inzot, ndë ka të bilt.

(5 prillit 1891)

**Vjershëth / Nji grueje vjershtare t'ëmbel**

At golez aq të ëmbel, që me hjë  
të madhe ndihet kūr ti fjet e kndon,  
ka e pate, lule dielli, që vë rë  
ka vete e vjen malli it, që të mirson?

Ka e pate, kanarin, që sido kë  
Një gōl të vetme aq këndimez bën;  
e aq m'i kënda zëmres kūr m'i jë  
gjellen sã dit e nat tīj vet kujton?

Oh malli të mburoft e Inzōt,  
që golez aq të bukur e të ëmbel  
të pikstin të më prënje me kaq mäll!

Të ruejshin e të gzoreshin për shëm mot!...  
Të mbjethshin ndë jet tire pra si ëngjell  
e trashigovsh të mirat, që s'kån zäll.

(17 shëndreut 1887)

**Vjershëth / Njij të Bùkurje**

Jë e mër sã s'undë dihet e të thuhet;  
jë e dashur e shërtuer më se një mäll!  
Të mirit tënd ka buza të kallzohet,  
ka sīt e bukur e ka e hjesmja bäll!

Vet'heza jote e dashme njerzvet ndëhet  
si pasiqir ku shihet buti mäll:  
ka pasiqiri tëndes gjëll butthohet  
malli, që të mirash dët pa zäll...

Për kët ti, hjeza Mallit të ndërue,  
mbë t'pār harepsen zëmrat e rrëmbën,  
e, si do, i qellen udhes zburuer.

Mandāj ti, kaq hjëmadhe, na shkëlqen  
Si Malli. Lumja ti, që jë ' dritsuer  
Ka Malli aq, sã gjithve më pëlqen...

(20 shëndreut 1887)



## Tringëllimet e Binard Bilotës (1843-1918)

### Viti që shkon 1890 Vjershth kultimezish

Ki vit si Krishti dish vo shkon për mua:  
jo aq i tharet, jo kutjend si e doja.  
Bëra e thash shurbise një sarua;  
të dilja mbë krie dreq, s'munda t'errëja.

Pres ni te viti ri t'errënj ku dua.  
Ndë Krishti daft. Dōj rroja mir të bëja,  
e të mbuloja me t'mira kët përrua  
atëj e ktëj pa drithem t'mund e shkoja.

Se t'errënj të dal mbë krie të trashigonj  
gjellen një kaq fanmīr, ndë nat ndë dit  
fjē: pa s'më vëlen se më e thartonj,

se jeta s'kã të rrën, ndë jep maj drit.  
Po, se t'mos rri i përgjumur, cambatonj  
dhe u si gjith, të reshtenj ngrah ndonj zdit.

(31 shëndreut 1890)

### Vjershëth Kultimez e keq për mua

Simbjete dita që ltiri kujton  
Të vdekurit, Donçicrat Qishes jasht  
më prit'tin të më vrisjen, përsa i cnòn  
se u s'i ndënj të lpijen fare nj'asht

mbë Qish. U t'hân s'i jap, se jân mbron  
e asish që kân shok kē hân kasht.  
Për griken, që kamot i turpròn,  
se s'i sosen ngadita nengu nj'dash,

Donçicrat shihen t'bjërr e paq s'kân,  
se s'i këndi māj të hajen me t'shurbier.  
Kuj s'i jep, mbi sī si djalli gjith ja kân.

Mandāj nd'at dit të strosur si aq grër  
kunder meje me thikt shkukur u pân,  
e vrār më kîn, ndë shpirtrat s'më kin ruer.

(16 Shën Martirit 1888)

### Vjershëth i përlipep Mbi timen moter

Së shoh u motren time të më vīnj  
nga çik ka u të pienj vo si m'e shkonj...  
Së pres u jo më māj, si do ksīnj  
e qānj t'e vrenj, kët zëmer të gzōnj...

S'e shoh u jo më māj..e dreq mund nxīnj  
të bardhat, poka që ajo s'më shtron  
më shtratin e së më livrīn me fīnj,  
ndë ndrishe mīr si heret më më bën.

Kush kish m'e thōj se u kisha të pësoja  
kaq vrër te kish birja motren time  
me k'prisja u dit't e mia po mīr të shkoja.

Ka māj u mund pandehja kët durime  
mbi mua, që Rozinen, moter doja  
aq sã nëng është mäll ndë ē rrëfieme?

(27 shën mitrit 1888)

### Vjershëth Luse Shën Mëris

Mëm e bukur, e si dielli e shkëlqier,  
e pa fare një vül si Biri it,  
ndëhju Krishtrimit gjith të jët rrëmbier  
ka hjët e tua që mburojen drit.

Ndëhju, mëm e ndriçme, e mbi të shtiër  
driten tēnde, që naten prier mbë dit:  
ndëhju, se sa të t'shōr aq mëm dritsuer  
rranga stroset ka ti e pshton djallit.

Ndëhju, mëm më një kaq se ti t'i ndëhe  
se t'mirit tēnd më i pâr vo gjith e rmbën,  
te e bukur si Parrajsi ti i butthohe.

O mëm që te parrajsi aq shkëlqën!  
Ndë ishe e pâr ndopak si ti zbulohë  
Ëngjëlvet, gjith të thojen: Mīrsevjen!

(15 gushtit 1888)

**Irena Gjoni**

nga Saranda

**Edhe dielli ndjek rrugën e tij**

*(cikël poetik)*

**Shamizeza bregase**

Shamisë së zezë të plakës së Bregut,  
njërin cep ia merr era e stihisë së marrë,  
edhe pse e rënduar nga pesha e “kufetës”  
bërë komb në skaj të saj,  
(Zakon i vjetër, kur kishte kujt t’ia jepte).

Cepi tjetër i zezonës,  
ngecur në një stivë drush të nxirosura,  
Kushedi sa dimra mbetur aty,  
se s’ka kush t’i djegë në vatër.

Përpiqet ta tërheqë në vetminë e saj,  
me mallkimin mërmëritës:  
“Mos u grisç!”

Me buzën që i dridhet,  
hedhur kryq u varën shpinës.  
Pa të nuk mund të nisë “Vajtimitin e vetvetes”  
parë nga përtejta, nga jashtëkohësia...

**Atdheu im**

Atdheu im,  
Ti ke erën e lisit  
Ku mbi ty një zog me zë njeriu,  
kumtoi kumtin profetik  
se aty i duhej ngritur një orakull Zeusit.

Ti jeton në shpirtin e lisit  
qyshkur bota vuri gurin e parë.  
Unë ha prej teje Zoti im pellazg  
vallahidhe e lënde ëndrrash të tua.  
I përtyp e bluaj me mokrat e shpirtit  
për të rrojtur prej miellit tënd  
e gatitur bukën e Diellit.

Zhurmerima e vijës së ujit,  
janë lotët e frymëmarrjes  
dhe fëshfërima e gjetheve të tua,  
që mendon edhe në gjuhët e vdekura  
përfaqime degësh e rrënjësh në largësi.  
E fatthëna përmes frushullimës së tyre,  
Më thotë se edhe kur mos të jem,  
sërish do bulosh vallanidhe ëndrrash për mua  
e do të vish me erën e lisit...

**Buzëqeshja, ëndrra që solli jehonën tënde**

Buzëqeshja është ëndrra që solli jehonën tënde,  
Ngjizjen e dritës në kundërmim universesh,  
ku Unë lexoj ajrin e Ti lexon në ajër.

Rrëmojmë në ritualin mistik të Shikimit të Kaltër,  
në fshehtësinë e thellësive të përjetshme,  
ku nën drita të verbërta, çorienton meridianët.

Frymëmarrjet, me Postën e Zotave postohen netëve.  
Sa më errët shkojnë, aq më tepër ka përndritje  
tek e qara e parë si kënga e sekreteve.

Udhëtojnë në kohë të tjera, në jehona ëndrrash.  
Bekojnë me mister një përkëdhelje flokësh,  
të dehur në një përfaqim në tehun e muzgut...

**Shtoi zot vallet**

Shtojzovallet kishin epoka pa bërë vizitë  
në botën dhe jetën e njerëzve.  
Kurioziteti shtojzovall nisi rrugën  
me fustane të bardhë antike  
që ngatërronin epokat, gojëdhënat.

... ..  
Hapën sytë  
në frymëmarrjen e zgjuar të njëra-tjetrës,  
sikur shumë bukuri,  
të kishin një mendje.

Kujtonin rrugën  
nëpër ngatërrim epokash, gojëdhënash.  
Takim me një shpirt të vrarë  
në momentin ku i lihej i pazhdukshëm  
një tatuazh zhgënjimi  
Dhe nga dhimbja klithte me tërbim sakati.

Shtojzovallet e dhimsura,  
kaq panë në botën e njerëzve  
në një vizitë,  
shumë më te shkurtër se rruga.

Gjithçka u dukej makth ëndrre, makth drite  
trupëzuar tek një flokëverdhë si shtojzovallet,  
ulur në hijen e zonjave të shtëpisë,  
duke thurur gërsheta tatuazhesh zhgënjimi  
të tepruara nga një natë më parë,  
në pritje të “MIRËMËNGJESIT” të shtojzovalleve.

**Irena Gjoni**

nga Saranda

Duke u ngjasuar me veten,  
me frymë i lanë trupin,  
me qerpikët e gjatë i krehën flokët,  
zërat dhe dritat ia qepën mantel,  
duke e bërë simotrën e tyre.

Nën ritmin shtojzovall:  
“SHTOI ZOT VALLET”,  
Shtojzovallja e re kërcente  
duke argëtuar dhe tatuazhin e zhgënjimit...

**E më le...**

Endet hija e shallit të zi,  
muzgjeve të mia  
tempullit të shpirtit.  
Nën klithma këmbanash  
që veç për mua bien.

Vetëm unë i dëgjoj,  
në një pikëllim  
që digjet jehonës së vet.  
E më le pa ty, malli im...

**Perënditë kanë etje**

Tani, Perënditë kanë etje  
Në këtë natë furtunash mbi dete,  
Ku me blic vetëtimash,  
Zoti fotografon mungesën.

Larg prej të përjetshmit shtrat shpirtëror,  
zjarret e vetmisë në këtë natë,  
lartësojnë hijen e mallit,  
ngjizur ëndrrash endur në eter.

Lutje qerpikësh të puqura në një lot,  
për të të pasur syrin, dritën, ajrin tim,  
misterin, ëndërritjen e një dashurie të pafundme.  
Me kokën mbështetur në gjoksin tënd,  
tek ngarend makinën e kohës horizonteve.

Ende perënditë kanë etje  
Në këtë natë furtunash mbi dete...

(është më)

**Klara Kodra**

nga Tirana

**Ujvarë dhimbjeje**

*(Për të gjallët dhe të vdekurit  
në Sardenjën e përmytur)*

Vërshon një ujvarë ... nga qielli vallë ?  
Më mirë do të thosha “nga skëtterra”  
Gjersa përpin njerëz të gjallë.  
Vërshon një ujvarë skëtërrore.  
Një tjetër ujvarë nga sytë njerëzorë.  
Ç’është ajo vajzë që s’ka as dy vjet  
E do të mbetet aq përjetë?  
Ç’është ai baba që fut nën xhup  
Katërvjeçarin vogëlush  
Që me përpjekje mbinjerëzore  
Qëndron i varur për një orë?  
Kush është ai që rend për ndihmë  
Dhe ata që s’tunden asnjë grimë  
Gjersa përbindëshi uxor  
Si gojë hap gjirin e vet mizor  
Dhe nuk ngurron që të përpijë  
Atë baba, atë fëmijë?  
- Je i lodhur, Lukë ?  
- Bëj pushim!  
- Po ata që presin për shpëtim?  
Në shtëpi grua e fëmijë me ankth  
Të presin ... Pritja s’ka mbarim.  
Përbindëshi ujvarë gëlltit vetë  
Pemë, shtëpi ...  
po edhe jetë.

Po shkruaj, po shkruaj dhe s’jam e zonja  
Prej uji mos qofshin këto shkronja.  
Prej zjarri qofshin, të pashuar.  
Për ju, për ju,  
për t’ju kujtuar.  
Është një përbindësh ...  
Jo si në përrallë.

Në jetë e përpin njerëz të gjallë.

Po kush për këtë fajin ka vallë ?

**Ndëse do të shkruash arbërisht mbi**

**Jeta Arbëreshe**

**(+39) 0981-32539 / jetarbreshe@libero.it**

**Giuseppe Gallo**

ka Shën Marcani (Ta)

**Shën Xhësepti**

Zoti dashi të ja rritënje  
i birëni e ti, bashkë  
me Bekuamën, bure  
të bëheshi i madhë,  
i mirë parë ka gjithë.  
Katundi inë të dashi  
si shendri ta tiji  
përçë je tata më i mirë  
çë gjëndet.  
Të duami mirë Shën Xhësé!  
E ti e din, ashtu si din  
se birtë e tona çë jesën  
largu, dita të feshtës  
jote lenjën ku mbanjën  
e rrjedhën ndë Katund  
pë të të shohën e pë të  
janë bekur ka ti, Shën Xhësé!  
Shën Xhësé! Shtir një si  
trimarjelive e vajzarelëve  
te tona, përçë zëmëra  
ime më thotë se kanë  
një det fëri.

A **SAN GIUSEPPE** - Il Signore volle che tu / crescessi  
suo figlio e tu, / insieme alla Benedetta / lo faceste  
diventare / grande e ben visto da tutti./ Il nostro paese ti  
volle / come suo Santo Patrono / perché sei il papà più  
buono / che c'è. / Ti vogliamo bene, San Giusé! / E tu lo  
sai , come sai che i nostri figli / che vivono lontano, / il  
giorno della tua festa, / lasciano tutto e corrono in paese /  
per vederti e per essere benedetti / da te, San Giusé! San  
Giusé ! / Proteggi i nostri / Giovani, perché il cuore mi /  
dice che ne hanno/ veramente bisogno.

(Luglio 2013)

**Nderi nëng blihet**

Nderi ishtë një trësor  
i madhë sa një mal.  
Gjithë mbami nderëni  
Ashtu si mbami zëmërën.  
I bugati bë t'blej  
karpotë më të ndara  
pë të vishët, dherët  
më të gjëra pë të  
mbielli, shtëpirët më

të madha pë të rrij,  
të hëngrë më i mirë  
pë të haj, por nëng  
bë t'blej nderëni, përçë  
nderi nëng shitët  
ashtu si nëng shitët  
shpirti e zëmëra.

**L'ONORE NON SI COMPRA** - L'onore è un tesoro  
/ grande come una montagna./ Tutti abbiamo l'onore /  
come abbiamo il cuore. / il ricco può comprare / le stoffe  
più belle / per vestirsi, i terreni/  
più ampi per piantare, / le case più grandi/ per abitare, il  
cibo / migliore per nutrirsi, ma / non può comprare l'onore,  
/ perché l'onore non si vende, / come non si vende /  
l'anima e il cuore.

(Luglio 2013)

**Të këndur të ndih të rrosh**

Një kapëshore bathe  
me lakre t'egra,  
një qerq verë më  
shumë të shpie  
ndë qiell.  
Me bark plotë ndihe  
një zot e të vjen  
të këndosh.  
Hëre këndon me zë  
i ngritër e moti  
shkon, ashtu si shkon  
dita e nata, ashtu  
si shkon gjella lart dhe.  
Çë do të rrosh  
me hare, kendo  
ashtu si këndonjën  
era e deti kur  
nëng e shpinjën e  
shtrëmbër.

**IL CANTARE TI AIUTA A VIVERE** - Un  
boccone di fave / e verdura selvatica, / un bicchiere  
in più / di vino ti inebriano./ con la pancia piena / ti  
senti un signore/ e ti viene voglia / di cantare./ Certe  
volte canti a bassa / voce, altre volte a voce / alta e il  
tempo passa / così, come passa la vita / sulla terra. /  
Se vuoi vivere con gioia / canta così come cantano /  
il vento e il mare / quando sono tranquilli.

(Luglio 2013)

## Poezia e zemrës arbreshe

**Telet e zemrës** (Faik Konica, Prishtinë, 2013) është përmbledhje poezish e Agostino Giordano -

**Muhamed Çitaku, asistent**

Universiteti i Prishtinës

Buzëdhelprit, e cila që në titull paraqet gjuhën e veçantë arbreshe në të cilën është shkruar, duke sjellur një freski gjuhësore në mesin e poezisë shqipe që botohet në Kosovë. Përmbledhja më vonë shohim se sjell të reja në nivel të figuracionit, të kompozicionit, të situatave të reja, të ndëlidhjes së tyre në një harmoni të shkëlqyer mes veti, etj. Pra, e reja formale që del nga gjuha e veçantë e kësaj përmbledhje në fakt është karakteristike e përgjithshme që prek shtresa të brendshme e të jashtme të poezive të saj dhe nuk është fjala thjeshtë për zbulime kamufluente që maskojnë poezitë me fasadë të bukur poezitë, bukuria është pjesë sa e jashtme ashtu edhe e brendshme e tyre.

### Sistemimi dhe karakteristikat

Në hyrje të kësaj përmbledhje, autori tregon se te Telet e zemrës përmbledhen poezitë e botuara në kohë të ndryshme. Ky informacion bëhet përcaktues për vlerën e lartë artistike të poezive të kësaj përmbledhje e cila mbledh poezitë antologjike të gjithë veprimtarisë së këtij autori.

Strukturalisht përmbledhja ndahet në katër cikle, tri ciklet e para janë poezi të përmbledhjeve të mëparshme (Nga përmbledhja “HROAZA” Castrovillari 1971, Nga përmbledhja “HAPA MBI KALLDRËM” Shkup 1976, Nga përmbledhja “BOTA ARBËRESHE” Tiranë 1997), ndërsa cikli i katërt është cikël i ri (TELET E ZËMRËS) prej të cilit kjo përmbledhje merr titullin. Duke vendosur në titull të gjithë përmbledhjes titullin e ciklit të poezive të pabotuara në përmbledhjet e mëparshme, A. Giordano vë theksin se mbi cilat poezi lexuesi duhet të koncentrohet më shumë. Pra, titulli i kësaj përmbledhje ka ngarkesë figurative dhe jep një mesazh lexuesit lidhur me poezitë e reja të përmbledhjes. Mesazhi në formë figurative i dhënë që në titull jep autorin që në këtë përmbledhje zgjedh figurën për të komunikuar me marrësin e jo tekstin e thjeshtë e të drejtpërdrejtë, zgjedh tekstin polisemik e me konotacione të mëdha për këtë shkak shenjat janë shumë universale dhe lehtë të komunikueshme me njerëzit e Kosovës, përkundër asaj që shkruhen prej një njeri nga një vend krejt tjetër, nga arbreshi i Italisë.

Në fund autori këtë përmbledhje e boton në Kosovë, pas përmbledhjeve të tjera që kishte botuar në Arbër të Italisë, në Maqedoni e në Shqipëri. Vendet e botimeve sikur bashkojnë copat e ndara të kombit shqiptar, pra kemi të bëjmë me vende figurative, duke na dhënë këto veprime fytyrën e poetit që Agostino Giordano bën edhe kur bën veprime politike e atdhetare në jetë.

### Gjuha dhe figuracioni

Gjuha e veçantë në të cilën janë shkruar poezitë e kësaj përmbledhje, shumë e përafërt me atë të romantikëve arbreshë (De Rada, Gavril Dara i riu etj.), është gjuhë që duke e njohur mirë autori arrin në një mënyrë të përkryer të shpreh emocionet e tij, mendimet e qëndrimet, përmes trajtave specifike arbreshe arrin të depërtojë thellë në probleme ku barten detajet kuptimore përmes shenjave adekuate dhe nuancave që trajtat e caktuara të fjalëve shprehin. Kjo na jep autorin e kësaj përmbledhje si mjeshtër të madh të përpunimit të gjuhës përmes të cilës arrin efekte dhe fuqi të madhe shprehësie estetike. Kjo fuqi e madhe estetike nuk vërehet vetëm kur shkruan arbërisht, por edhe në variantet e tjera të gjuhës shqipe si në dialekte, lokalizma, ideolekte profesionale etj., përmes të cilave arrin efekte të larta estetike, të njëjta me ato efektet e arbërishtes, veçse tash me një vokabular tjetër gjuhësor. Kështu A. Giordano - Buzëdhelprit përdorë shpesh edhe gegnishten, madje jo çfarëdo gegnishte por atë tipike kosovare kur shkruan për jetën e Kosovës (psh te ‘Nata e Kosovës’), një gegnishte shumë e pasur me trajta e frazeologji tipike kosovare, duke realizuar me përpikëri atë që quhet figurë e fjalorit ku gjuha specifike (dialekti, lokaliza etj.) përdorët qëllimisht për të dhënë të folurën e vendit dhe të njerëzve për të cilët flet. Trajatat e frazeologjia e pasur, si kur përdorë arbërishten, ashtu edhe kur përdorë gegnishten e Kosovës, tregojnë se ndërrimet gjuhësore shoqërohen me një mori elementesh gjuhësore çka tregon se autori si njëri ashtu edhe tjerë botë gjuhësore e njeh mirë, secilën e përdorë në kontekstin e duhur, shumë adekuat për temën që diskuton, duke përmbushur secila funksionin e vet estetik në mënyrën më të mirë të mundshme.



## Poezia e zemrës arbëreshe

Poezitë e përmbledhjes përdorin shumë figurat e fjalës si metaforën, metoniminë, antropomorfizimin e gjërave të vdekura, të gurëve, rrugëve, detit, tokës etj. Metafora njihet teorikisht se del kur fenomenet e vdekura sillen si qenie të gjalla, kjo rregull vlen edhe për metaforën e poezive të këtij autori, por realizimi arrihet në një formë shumë të veçantë. T'i kujtojmë disa prej tyre për të përforcuar këtë mendim, por edhe për të parë veçantinë e tyre, bukurinë, mjeshtrinë në ndërtim dhe vendin e duhur ku përdorën: këtu fjala qepet me puthje ('*Një fjalë me turp/e qepur me një puthje*'); bariu kullot shpresa e 'tier' ëndërra ('*me delarin që kullotën/shpresa ndëpër bregje*'... '*me delarin që tier/ëndërra ndëpër dushqe*'); sëmundja ecën ('*Shoh sëmundjen/që ecën mbi eshtrat e plakut*') etj.

Ajo që i dallon këto figura është se në këto poezi ato nuk kanë qëllim në vetvete, ato janë vetëm mjete ndihmëse përmes të cilave arrihet një ide e botëkuptim i caktuar, veçse më me ambiguitet e polisemi, më me emocionalitet, thellësi mendimi, diksion, ritëm etj. Kjo tregon se teksti i poezive të kësaj përmbledhje nuk është i thjeshtuar në një ide, ai është tekst që ndërthurë elemente të tëra poetike që efekti estetik të jetë sa më i madh. Në këtë frymë realizohen edhe figurat e tjera, madje edhe ato elementare, si epiteti, pyetja retorike etj. Për këtë shkak komponimi i tekstit është çdoherë i njëjtë, pavarësisht ndërrimit të figurave. Pikërisht për këtë shkak teksti është i komplikuar edhe atëherë kur nuk ka figura fare, duke tingëlluar i ngjashëm me tekstin figurativ.

*'S'di më t'i ndërronj fjalë / vajtimit të mbrëmjes të gjindjes sime'*

Kjo flet edhe për një karakteristikë tjetër të këtyre poezive, për atë se poeti nuk përdorë figurat rast e pa rast, vend e pavend, nuk përdorë figura të tepruara por vetëm aty ku është e domosdoshme. Prandaj tekst i këtyre poezive është mjaft i rezervuar ku autori përpiket ta jap idenë vetëm me aq tekst sa është i nevojshëm, duke mos e zgjatur me numeracion figurash të vend e pavend. Kjo karakteristikë e shkrimit të tij ka prodhuar poezi kryesisht të shkurta, por të reduktuara maksimalisht në shenja që mbajnë fort boshtin e poezisë dhe të cilave mjafton shpesh një fjalë t'i hiqet për t'u bërë i pakuptueshëm i gjithë teksti i tyre. Tekstet e rralla që janë të gjata, dëshmojnë nga ana e kundërt, se poezia e shkurtër është ajo që i shkon më së shumti këtij autori.

Në fund, figura që zë vendin më të madh në këto poezi është kontrasti ku autori ndesh dy botë të kundërta: ditën - natën, ëndrën - realitetin, lirinë - robërinë, dashurinë - zgjënjinim, bashkimin - ndarjen, ndezja - shkuarja ('*çë s'dimi si u çel/çë s'dimi si shuhet*') etj. Shtrirje që mbërrin deri te titulli i poezive, si '*Qetësia ime, mëria jote*'. Krahas saj, poezia '*Vashës sime*' ndërtohet tërësisht mbi figurën e kontrastit, madje të një kontrasti të ri nga ai që përmendëm më lart, çka tregon se kjo figurë përdoret shpesh por çdoherë në variante, pra edhe ajo që përsëritet është e menduar mirë, çdoherë del me formë të re, në situata të reja, personazhe duke ruajtur vetëm emrin e njëjtë të figurës:

*'Më pëlqen ngaherë / edhe kur thua se s'je e bukur / Të kujtonj ngaherë / edhe kur t'duket se s'të gjegjënj  
Të vërenj ngaherë / edhe kur thua se ruanj gjetkë'*

### Idetë dhe kompozicioni

Poezitë e Agostino Giordanos trajtojnë tema jo të reja në kuptimin burimor (e dashura, babai, nëna, bujku, bariu, i varfëri, etj), por të reja në kuptimin e frymës në të cilën janë shkruar, stilit të ri, figuracionit e situatave të jetës së re mbi temat e vjetra. Ja si paraqitet bujku dhe jeta idilike :

*'Sonde / të dërgoj një lule / bujk / Fytoje ndë vreshë / afër asaj dhrije / që s'lidhi vjet Mos më pyet "si më njeh" / Mblodha shërtimet e tu / e i vlova nën kuponjën e madhe'*

Pra, këtu e vjetra dhe e reja shkrihen natyrshëm, mirë dhe harmonishëm, duke freskuar mallin e të kaluarës nën dritën e jetës së re. Një mjeshtri kjo e zgjedhjes së temave tejkohore brenda çasteve të një jete shumë dinamike që tashmë jetohet. Pjesa tjetër janë poezi që trajtojnë temat e modernitetit, si atë të jetës së ftohtë të saj, me plot boshësi, pakuptimësi e pritje, jetën që kalon shpejt dhe pa një qëllim në veti:

## Poezia e zemrës arbëreshe

‘...E shkoi edhe sonde / si dje / si ngaherë / Udha / qëndroi e bardhë / pa një përgjegjje / Gurët / u pyejtin / pse i shkelja ngadita’

Kompozicionalisht kemi të bëjmë me një poezi që vargjet i ka të ndërlidhura në fraza të gjata, të cilat funksionojnë mrekullisht mirë brenda poezisë: fraza shtrihet në disa vargje, secili varg ka kuptimin e vet autonom, por ata edhe plotësojnë kuptimisht njëri tjetrin në atë mënyrë sa që nuk mund të kuptohet fraza pa lexuar të gjitha vargjet nëpër të cilat ajo shkrihet:

‘Bie hollë hollë / sikur i dhëmb të cënonjë / rrusht që janë e lidhjen / sikur trëmbet / t’i mbëshonjë folesë së zogut’

Ka një vetëdije edhe autoriale për këtë çështje, çka tregon se e gjithë kjo mjeshtri e madhe kompozicionale ndërtohet vetëdijshëm nga A. Giordano dhe është e kontrolluar mirë intelektualisht. Prandaj kompozicioni i tillë përveç ndërtimit të brendshëm në të cilin hetohet një saktësi e madhe e fjalëve, vargjeve dhe e togëfjalshave të shtrirë brenda frazës, hetohet edhe një rregullim i mirë formal i saj. Autori në këto poezi nuk përdor pikësimin fare, por vargjet herë i fillon me shkronjë të madhe e herë me shkronjë të vogël. Ka një logjik dhe një rend në gjithë këtë që duket si kaos, ku s’ka pikësim por ka vargje që fillojnë me shkronjë të madhe e vargje që fillojnë me shkronjë të vogël. Përmes shkronjave të mëdha e të vogla A. Giordano rregullon formalisht frazën: vargu që fillon me shkronjë të madh tregon fillimin e frazës, të gjitha vargjet pasuese që fillojnë me shkronja të vogla tregojnë vargjet nëpër të cilat ajo frazë shtrihet. (...)

Nganjëherë edhe vet titulli i poezisë është pjesë e frazës, si në poezinë që cituam e cila kuptimisht është e paqartë nëse nuk ia kujtojmë titullin ‘Bie borë’, shembull që tregon se ka një mjeshtri të madhe në ndarjen e frazës nëpër vargje, në shpërndarjen kuptimore të saj në secilin varg duke arritur me të autori ta ruaj enigmën e problemit për të cilin flet deri në fund të gjithë frazës e herë deri në fund të gjithë poezisë.

### Mikrofabula

Përkundër shkurtësisë së poezive dhe përdorimit të kursyer të shenjave, vetëm të atyre që janë të domosdoshme, prapë se prapë pjesa më e madhe e poezive të këtij autori kanë një mikrofabul, sado e shkurtër qoftë ajo, si një ecje, një udhëtim, një mbrëmje me miq, një puthje nga e dashura etj. Në fakt të gjitha situatat e mikrofabulës janë figurative çka tregon se në këto poezi përveç fjalëve figura ekziston edhe një figuracion më i madh që përfshinë të gjithë poezinë. Shkurtësia e madhe e disa poezive, bën ato shpesh të mos arrijnë të ndërtojnë mikrofabulë të plotë por vetëm një situatë të caktuar.

‘Bie e qetme / Si mëmë që lan liveret / natën / e ndën vesh / ngaçik / ndë biltë vo fjenë (...)

Karakteristikë e përgjithshme e tyre është se situatat e këtyre poezive janë të përzgjedhura me mjeshtri, prandaj kryesisht kemi të bëjmë me situata të çrëndomta që kanë fuqinë e dhënies së idesë me nuanca të forta ekspresive që kanë fuqinë e përcjelljes së idesë me emocione të forta. Shembujt më lart dhënë rastet kur jeta ka kaluar në boshësi të përhershme, rastet jo të borës së rëndomtë por kur ajo është e çuditshme nga bukuria dhe eleganca me të cilën bjen, te poezia Kur ti qeshëm, mëm diskutohen dy rastet ekstreme të disponimit të nënës, atë kur qanë dhe atë kur qeshë, te Vashës sime zgjedhet situata e dashurisë së vashës pikërisht kur thotë se nuk jam e bukur, e dëgjimit të vashës pikërisht atëherë kur duket se nuk është duke e dëgjuar fare etj. Pra, situata të veçanta, të çrëndomta prej bukurisë, por shpesh edhe prej krizave të mëdha të brendshme e të jashtme. Kjo tregon se autori mundohet ta zë jetën në çaste shumë të veçanta, shumë specifike, krejt të jashtëzakonshme, ta zë jetën në çaste të krizave të mëdha, të zhveshura plotësisht prej maskave të përditshmërisë, etj.

## Poezia e zemrës arbëreshe

Tipi i tillë i poezive me mikrofabelë ose me situata të caktuara shtrihet kryesisht në pjesën e parë të poezive të botuara në përmbledhjet e para, krahas poezive të mëvonshme që mbështetën më shumë në motive asociative të ndërlydhura për një ide bazë që shpesh është ide që në formë të thellë e të hollë trajton probleme të kohës, jetës e shoqërisë në përgjithësi. Kjo tregon se poezia e këtij autori ka evaluuar prej një poezie me mikrofabelë ose me situatë drejt një poezie me ngarkesë të madhe filozofike e meditative. Tipin e tillë të poezive me motive asociative e hasim edhe te poezitë e gjata të kësaj periudhe (psh te Qetësia ime, mëria jote ose E kushtuar njëi vashje kosovare) ku ka hapësirë të mjaftueshme për ta shtrirë mikrofabelën ose situatën por që nuk e bën ngaqë tash shkruhet në frymën e poezive të fundit pavarësisht hapësirën së madhe që ato mund ta kenë.

### Konkludime

Përmbledhja "Telet e zemrës" është përmbledhje që, në fondin e botimeve të fundit, arrin të sjell një freski me formën e veçantë të trajtimit të temave të vjetra, duke na ofruar një pamje krejtësisht të re të tyre aq sa duken sikur po ndeshemi me to për herë të parë. Autori A. Giordano/Buzëdhëlpri duket se ka një intuitë të hollë në identifikimin e situatave shumë të veçanta kur flet për këto tema, çka ndikon që hejona e ideve të ndihet më shumë, të jetë më e fuqishme dhe të pritët me një kureshtje më të madhe nga lexuesi. Metafora, apostrofimi i gjërave të vdekura dhe personifikimi i natyrës, bën që jeta të fitojë një karakteristikë të fortë mitike në poezinë e tij duke dalë jashtë mediokritetit të çasteve ditore në një reflektim mbi gjithësinë përgjithësisht, prandaj lexohet dhe kuptohen lehtë nga lexuesi i vendeve të tjera shqiptare e jo vetëm nga ai arbresh i Italisë. Poezitë kanë një përpunim të mirë gjuhësor, një vetëdije të pozicionimit të shenjave, të formës së shkrimit të tyre, një përpunim të mirë të frazës së shtrirë në disa vargje me një kuptim që gjithmonë është në plotësim të atij kryesor duke arritur që me mjeshtri ta ruaj enigmën e problemit deri në fund të gjithë poezisë. Ky kombinim figurash, idesh, gjendjesh të veçanta emocionale e shpirtërore të dhëna përmes një gjuhe të përpunuar mirë në nuanca do të përshkojë gjithë poezinë e këtij autori, një botë komplekse që nuk di për rrëshqitje të mundshme në monotoni.

## BIBLIOTEKA E JETES ARBERESHE

### "Veprat" e zotit Emanuele Giordano:

Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230 .....	€ 10
Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160 .....	€ 10
Himne Liturgjike Bizantino-Arbëreshe – 2005 – ff. 217 .....	€ 10
Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.) .....	€ 10
Fjalor - edic. 2000 - ff. 715 .....	€ 30
Shpata e Skanderbekut, di B.Bilotta – 1967 - ff. 217 .....	€ 15
Folklore albanese in Italia - 1957 - (fotok.) .....	€ 10

### "Pro Manuscripto":

Shërbesa e Orëvet, Lutjesorja, Mbrëmësorja e Madhe, Shërbesa e Varrimit, 2008, ff.114, (fotok.).....	€ 8
Vangjeli i perëndishëm dhe i shëjtë (Evangelario), 2010, ff.280, (fotok.) .....	€ 10
Apostulli (Epistolario), 2010, ff. 270, (fotok.) .....	€ 10
Liturgjia Hyjnore e të Parashëjtëruaravet (Projazmëna) , 2011, ff.100, (fotok.).....	€ 8

**Telefononi: (+39) 0981-32539 / Shkruani: [jetarbreshe@libero.it](mailto:jetarbreshe@libero.it)**

## Dashuri e munguar, apo vajtues i dashurisë ?

Të Elegjitet e Serembes janë shkrirë me mjeshtëri të rrallë jo vetëm motivet erotike, por edhe ato filozofike apo motive të natyrës. Natyra vë veprën e Serembes bëhet pjesë e elementit përshkrues, ku dhimbja ndihet stoike, sikur ajo është shkrirë me meditimin. Sipas studiueses Klara Kodrës: *“Elegji është një farë ditari lirik i poetit”*.<sup>1</sup> E ndërtuar në formën e monologut- rrëfimit, duke i dhënë kështu formën e dashur për romantikët. Vjershat e tij duken sikur zbulojnë çdo skutë të shpirtit të poetit, ndryshe këto vjersha mund t’i quajmë edhe si vajtim kozmik i humbjes tek poeti. Ndërsa poezia *“Kujtim”* është një nga poezitë e këtij poeti më tipike romantike i cilësuar si poeti i dashurisë së munguar. Nostalgjia, joshja nga bota e kujtimeve kanë gjetur një shprehje origjinale në krijimet e tij dhe në elegjitet për të cilat dallohet dukshëm. Momentet e hovshme të pasionet alternohen me çaste meditimi. Kontrastet e forta shprehin në mënyrë të gjallë dhimbjen e thellë të poetit, iluzionin e tij të përkohshëm se po i kthehet lumturia e shkuar dhe dëshpërimi i dyfishtë kur zëri i arsyes i thotë se, vasha nuk do të ngrihet më nga varri:

*“Ja dielli perëndon, dhe po më vjen,  
Terri që depërton tok me puhinë,  
Vij në vete tani edhe më len,  
Ëndrra që në jetoi në fantazinë  
Dhe shoh që jam si cisha e kurre më  
Sçmë ngrihet Bardhusha që te varri fle”*.

Motivi i ëndrrës si largim nga realiteti i dhimbshëm shkatërrohet. Poezia është e çmbështjellë me një atmosferë dhimbje të thellë. Ai kërkon që fytyra e vashës së vdekur të jetë për të, burim mendimesh fisnike dhe frymëzuese, për një lartësim morali. Serembe e mbyll këtë poemë me vargjet:

*“Ti urimin nëm, o shpirt, unë të bekoj,  
Mbi varrin lule e lule unë të vë,  
Ngryset pra jeta e flë, dhe unë aher,  
Ngjallem në jetën tjetër e së të bjer”*.

Kjo poezi karakterizohet nga lirizmi i thellë, psikologjizmi e introspeksioni, me vargje njëmbëdhjetë rrokësh e me strofa gjashtëshe. Dhimbja hedh mbi të nota elegjiake. Në të dy poezitë *“Elegji”* dhe *“Kujtim”*, përmes një

**Rovena Vata**

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

lirizmi të kulluar kanë gjetur shprehjen e tyre të plotë, problemet filozofike dhe shoqërore - etike, që mundonin poetin. Këto poezi karakterizohen nga ekuilibri midis ndjenjës, spontanitetit të frymëzimit dhe përmes punës së kujdesshme artistike. Janë poezi meditative - lirike dhe pasqyronjë kontraditën e përhershme midis idealit të poetit dhe realitetit, në to gjejmë krahës motivit të vetmisë e të kujtimeve, tablo plot dritë nga jeta si dhe kontrastin midis misticizmit dhe dëshirës për gëzimet e jetës. Poezia Shën Mërisë Virgjër, është një poezi ku poeti shpreh dhimbjen e tij, këtu ai shfaqet krejt ndryshe, si një njeri i pangushulluar, si një njeri i vetëm, i braktisur, tashmë jo vetëm nga dashuria e jetës së tij, por edhe nga Shën Mëria. Një poezi kjo e ndërtuar mbi bazat e pesimizmit të thellë:

*“Tani ç’ të bënj, o Mëmë, te kjo jetë  
Dita më helmon, kurse nata më vret”*.

Poeti përdor çiftet ditë - nata, helm - vret, e sotmja që ngrys dhe e nesërmja që zhyt. Këto elemente janë gjetje origjinale e poetit, të cilat janë bartëse të një ngarkese të madhe emocionale. Serembe shpreh braktisjen nga Shën Mëria, madje ai nuk kërkon më ndihmë asaj sepse nuk beson dhe nuk shpreson më në të. Ajo - Shën Mëria - është e largët për të:

*“Më ngrys e sotmja, e nesërmja më zhyt,  
Po ti rri larg dhe brenga mua më vret”*.

Sipas A. Stratigoi: *“Dhimbja, notat pesimiste janë zotëruese në këtë poezi, por kjo dhimbje nuk e bën poetin të përdorë mallkime e fjalë sulmuese të furishme, nuk e shtyn as që të ngrerë krye kundër shoqërisë dhe as kundër zotit”*<sup>2</sup>. Në këtë sonet poeti e ka humbur përfundimisht shpresën të feja, ai duke mos gjetur rrugëdalje e vështron jetën me pesimizëm. Pra, ky sonet, shpreh gjendjen e poetit që e shpie kah fundi, i cili kërkon së paku një pikë të mbështetjes së referimit, para së cilës do të ndërtojë, nga plaga e vet, tregimin përfundimtar apo rrëfimin. Në lirikën Qyqezës, Serembe personifikon fatin dhe shpirtin e tij të helmuar. Elementet besimtare popullore mbi qyqezën dhe këngën e saj, i përgjigjen jetës dhe fatit të vetë plakat thonë, kur

## Dashuri e munguar, apo...?

### Rovena Vata

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

këndon e punon, “*Vjetët gjindjes i numron*”.  
Qyqëza fluturon pa atdhe, ajo këndon për bijtë e saj që i mbesin të larguar nga njëri - tjetri dhe nga ajo,  
“*Prandaj bën. Kuku! Kuku!*  
*Bijtë e mi ku jeni ju?*”.

Poeti këndon me shpirt të lënduar, me dashurinë e porealizuar dhe me vashën që vdiq në largësi, këndon gjendjen e mjerueshme në tokë. Dialogu i poetit në këtë vjershë është bërë lidhur me gjatësinë e jetës dhe dashurinë e vashës. Shprehet në këtë rast edhe një mospajtim me atë që ofron jeta dhe ajo çka vjen prej saj. Pas humbjes së dashurisë së vashës, poeti përpigjet të vetë ngushëllohet për disa me atë çka i ofron jeta.

Poezia “*Fytyra ime*”, ka dy tingëllima, i pari jep pamjen fizike të poetit, që nga trupi, sytë, vetullat, mjekta vezake, duart e holla, humda me majë. Sytë si lulediell, flokët gështenja, i shkathët posi një Akil. Këto janë disa veçori që poeti ia vesh vetes. Ndërsa, në tingullin e dytë, kërkon të shfaqë thellësinë shpirtërore, si dhe një pamje morale. Në këtë sonet, kemi të bëjmë me poetin e rebeluar, që mundohet të përshtatet dhe kur nuk mundte të bie në pikëllim. Më zë inati, po shpejt e kapërcej. Në tingëllimën, “*Fytyra e saj*”, dashuria dhe bukuria janë dy mitet e mëdha të poetit:

“*Si vajza ime bukur ska asnjë  
E prerë, e hollë si kumbull, drejt më rri*”.

Këto vargje japin portretin e dashurisë, lidhjen fantastike me vashën në një gjendje të re shpirtërore. Poeti, arratiset, i largohet gjendjes së rendomtë. Pra, fytyra e asaj, e vashës lidh bashkë cilësitë fizike e shpirtërore, prandaj këtu krahas përshkrimit kemi edhe elemente emocionale - dashurore - pëlqyese, që hyjnë në cilësim. Kur qesh të shpie në qiell:

“*Dorën dhe zverkun si alabastër vënë,  
Edhe, kur qesh, sikur të ngre në qiellë*”.

Përshkrimi shpie më tepër nga përshkrimi i bukurisë ideale.

1) Klara Kodra, “*Veçori të stilit në poezinë e Zef Serembes*”, Naim Frashëri, Tiranë 1975, f. 135; 2) Albert Stratigoi, *Zef Serembe, Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944*, Nasho Jorgaqi, Naim Frashëri, Tiranë 1979, f. 192.

## Dukuri leksikore te Kënga e Balës<sup>1</sup>

### Asime Feraj, doktorante

Vlorë

Në këtë punim synoj t’u vij në ndihmë nxënësve dhe mësuesve të gjuhës dhe lëtërsisë shqipe për të argumentuar sa herë që është nevoja, lidhjen e arbërishtes me gjuhën mëmë. Objekt është bërë “*Kënga e Beratit*”, duke qenë se është e përfshirë në programet shkollore, është mjaft e njohur dhe materiali gjuhësor ilustrues mbahet mend me lehtësi. Lidhur me përkatësinë dialektore arbërishtja e Italisë, sipas Çabejt, i përket toskërishtes jugore<sup>2</sup>. E konkretizojmë këtë me materialin gjuhësor të vjelë me kujdes nga “*Kënga e sprasme e Balës*”.

Vjeljet dialektore janë ndarë në fjalë, shprehje, variante fonetike, trajta gramatikore e fjalëformuese. **Dukuri leksikore:** Disa nga fjalët dhe shprehjet dialektore janë dhënë të shoqëruara nga përdorime të jetës së përditshme në krahinën e jugut, për të parë se këto fjalë dhe shprehje vazhdojnë të gjallojnë ende në të folurën popullore të dialektit tosk.

**Emrat:** *dylfeqe, odë* (shumësi i fjalës dyfek “do të marr dyfek që kam o moj nënë do luftoj për vatanë o moj nënë” vargje nga kënga për Miro Tërbaçin; oda e miqe, oda e grave, burrave etj.); *Van’ të nxirat* përmbi kodër, të mjerat, kemi fjalën e urtë (*u nxifsh me bojë, u bëfsh katran*) u turpërofsh, u dëshpërofsh shumë; *kalidhen* (hapi kalidhen e tij, vajti në kalidhen e tij, shtëpinë); *qift* (sqyfer), vihet re afëria tingullore; si dhe fjalët me përdorim të shpeshtë *dylmer, vasha, motnë* e shkuar (motin që vjen);

**Mbiemri:** *kopeja e bushtër*, përdoret ende me ngjyrim të forta keqësuese (është bushtër);

**Ndajfolje:** shtruan një udhë *kaq* (shumë) të gjatë, që *menatë* (zgjohen me natë);

**Folje:** *zu e u zbyth*, nga tradita e të qëndruarit ulur në shesh, u zhvendos;

**Shprehje:** *me ballët kthyer qiellit* (i ktheu patkonjtë nga qielli, vdiq, me kuptim keqësues), *bukë e kripë*, në formulat e mikpritjes është shtuar edhe *zemër* (bukë e kripë e zemër), apo përdorime të tjera si: (bukë e kripë e në shtëpi) për të treguar sa e shtrenjtë është shtëpia; *kryet përpoqën në atë ledh* kemi në përdorim shprehjen (nuk i bihet murit me kokë) për të treguar diçka të pakalueshme, *ngritën pirgje k’u e përtej* (ende në përdorim si njësi matëse në të folurën popullore, shumë larg), *solla një pikë*



## Dukuri leksikore të “Kënga e sprasme e Balës”

ujë kujtojmë vargun e këngës popullore vlonjate “Hidhëm një pikë ujë, moj baluke prerë / me se do të hedh o trëndafil me erë”; *më s’i nxuri dhe i plasi* (i plasi zemra, shpirti, koka, mëlçia nga mëzitja dëshpërimi etj.).

**Urime dhe mallkime:** *Ju përher’ të lumë qofshi! Paç uratën!* Në dasma e fejesa shprehet urimi (Qofshi të lumtur për jetë e motë!), “Si moriuratën e nënës u bë tri herëmëifortë”, tek “E bija e Hënës dhe e Diellit” nga Faik Konica. Urata në traditën e sotme lidhet dhe me fijet e bardha, flokët. Është e njëjtë nga ana kuptimore me *Paç uratën!* (Ja, për fijet e bardha!), duke e kaluar dorën mbi flokë.

*Mos të rëntë nëma e zezë!* (nëma, mallkimi “Deti është si një nënë të nëm, të mallkon, po mua nuk më ka nëmur kurrë se unë e dua detin”, P. Marko te “Shpella e piratëve”)

**Eufemizma:** *u sos; u shua*, për vdiq. Krahas fjalëve kemi edhe shprehjet: U shua si qiri! Iu sos vaji kandilit! etj.

**Pasthirrma:** *Ububu!, derëziu, Deh...!, Moj* e bukur. Kujtojmë vargjet popullore: “Derëziu që kur kam lerë hyzmeqarë derë më derë, me një këmishë të çjerrë”. Pasthirrmat *Ububu!, derëziun ç’e gjeti!* E ndeshim shpesh në të folmen e përditshme.

**Pjesëza:** *mu* në mest, Në tregimet popullore kemi përdorime të shpeshta të pjesëzës *mu*: Hipi *mu* në maj të pemës! Kjo bëhet për ta përforcuar më tepër idenë sa lart hipi.

**Fjalëformimi:** Në fjalëformim dallojmë prapashtesat zvogëluese dhe përkëdhelëse *-zë, -th*: e *kurorëzat* mbi shtrat, kafshon *pakëz* bukë e kripë, *lulëz* e këputur, *fjalëzën* e ëmbël; a *birëthin* e humbe, *vëllauthi* im, *dhëndërith* i ri,

Për ilustrim sjellim vargun popullore “o moj *çupëza* nga Vlora”; Naim Frashërin në poemën “Bagëti e Bujqësi” me “o *vendthit* e bekuar ju mendjen ma dëfreni..., kur dëgjon *zëthin* e nënës si e le qengji kopenë ...”; apo Mitrush Kuteli te “*Rinë Katerinëza*” midis shumë rasteve të tjera të përdorimit të këtyre prapashtesave duke nisur që nga titulli vazhdon në të gjithë rrëfenjën: “Shkoj një copë herë dhe, kur dor’ e Kirolojt i përkëdhelë ëmbël e lehtë *flokëzat* – kaqë *ëmbëlthi* e kaqë *lehtazi* si vetëm dora që ka shkuar nëpër jetën e varrit munt të përkëdhelë...”

**Dukuri morfologjike:** Nga pikpamja dialektore interes paraqesin forma e shumësit të emrave. Marrin mbaresë rasore me *-t, -et, -vet* në vend të mbaresave *-i, -ve*

Emërore: është si *vajtë* e kandilit,

Gjinore: tymi i *dyfeqevet*, zbardhëllimit të *shpatavet*, gjakut të *ushtarëvet*, gardhin e shkretë të *heshtavet*, e nga gjith’ shpella e *malevet*, mu tek eshtrat e të *vrarëvet*,

Dhanore: u ranë *shporavet*, prapa të *dhjetëvet* u mbyll,

Kallëzore: edhe hapën *dyert* të gjera, e ka *ballët* si dielli; (si emra të gjinisë asnjane).

Vendore: mbi *sheshet* ngriheshin male, u vërtitën mu në *mest*.

Përdorimet me mbaresën *-t*, ndeshet shpesh në të folmen toske. E dukshme kjo në vargjet popullore, kujtojmë vargun popullore kënduar nga Eli Fara “ballët me sedet ...” si edhe në të folmen e përditshme në fshatrat e rrethit të Vlorës, më e theksuar në fshatin Gorrish: erdhi në këmbët, në darkët etj.

**Ndryshime fonetike në përbërjen e fjalës:**

tënë: **ë>o**; kreje, **ej>y**; thom, u thom, **o>e**, u>unë; vej e vinin-**j>nin**; tëmërgjërën “...ec në të mëngjër biro, ec në të djathtë...”, Lumo Skëndo në “Ay mal”; në të folurën popullore (është më ngjarash), *ndënë>nënë*, me protezën **d**; *mëritur* nga mëri;

Në përfundim dua të theksoj se gjuha e letërsisë arbëreshe megjithëse e studiuar mjaft, paraqet ende interes për dialektologët dhe historianët e gjuhës shqipe dhe çdo studiues të gjuhës shqipe, pasi ajo ruan të gjallë dukuri leksikore të shqipes mesjetare.

E. Çabej thekson, për shqipen që flitet në bashkësinë arbëreshe të Italisë, se: “...me barazimin arbërisht-toskërisht nuk shpjegohet gjithçka në këtë problematikë”<sup>3</sup>, kështu letërsia arbëreshe do të vazhdojë të shërbejë si mbështetje për studime të tjera gjuhësore.

1) Gavril Dara i Ri, *Kënga e sprasme e Balës*, Biblioteka e nxënësit, Shtëpia botuese Naim Frashëri; 2) Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, f.306; 3) Po aty, f.305.



## Ndajfolja në gramatikat arbëreshe

Në kuadër të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, ndajfoljet zënë një vend të rëndësishëm. Nga ana kuptimore ato janë mjaft të larmishme, sepse tiparet dhe rrethanat që emërtojnë janë të shumta (Gramatika e Akademisë I, 2002:358). Ndajfoljet dhe llojet e tyre, krahas pjesëve të tjera të ligjëratës, janë trajtuar në një varg gramatikash. Edhe autorët arbëreshë kanë dhënë një kontribut mjaft të çmuar në trajtimin e tyre, duke pasqyruar në gramatika veçoritë kuptimore e strukturore të ndajfoljes, si dhe duke i radhitur ato sipas asaj çka shprehin.

Në *Grammatica della lingua Albanese* (1965), **G. De Rada** e përkufizon ndajfoljen si “*ffjalë të palakueshme që modifikon veprimin e foljes dhe të çdo cilësori, të cilit i bashkangjitet e që mund të pranojë prapashtesa përkëdhelëse e zvogëluese*”. Ai konstaton që shumë ndajfolje janë formuar, në analogji me greqishten e latinishten, nga emra e folje nëpërmjet prapashtesave –*isht* ose –*t* (f.99).

Ai dallon këto lloje ndajfoljesh:

(1) të mënyrës: *ljuum, shpét, ljich, miir, urtëritisht, búrrërisht, ljëtishtë etj.*; (2) të vendit: *attié, chëtù, anembaan, cudò, cãdò, passandai, attteija, chëteina, attiéteina, chëtiétei, përposh, përsiper, përpapa, prãpa, posht, cuntréla (carshi) etj.*; (3) të kohës: *sot, somenàt, sonte, njëménd, diè, diémenàt, diémbrëma, mbrëmanet, mot e mot, nattën, mënès, vonu, njëhère, akëheer, ndònjëheer etj.*; (4) të pyetjes: *mos? po? pse? pë çë?;* (5) të shkakut: *përdicca, se, andai, përandai.*; (6) të pohimit: *mbase, ashtë, chëshit ù, maide, ndòpach, njoo, njotta, ndòmòs, ndòrhìma etj.*; (7) të mohimit: *jo, as, fare, nëmòs, monu, ndrìshe etj.*(8); të sasisë: *chëké, shuum, pach, cakë tam, saa quam, tepër.*; (9) të dyshimit: *macari, ndòde, ðomse.*

**Angelo Leotti** në *Grammatica Elementare della Lingua Albanese* (1915) i përkufizon ndajfoljet si “*ffjalë të palakueshme që shërbejnë për të modifikuar mbiemrin, ndajfoljen ose foljen në të njëjtën mënyrë që mbiemrat shprehin cilësitë ose pronësinë e emrit*”(f.167).

Duke i konsideruar si më të përdorurat, ai dallon këto lloje ndajfoljesh:

(1) të vendit: *ku, këtu, atje, nga, ngaha, përjashta, lart, poshtë, lark, afarë, siprë, kudo, tekdo, gjetëkë, mbë të-djathitë, mbë të-mëngjërë, kurrkunt.*Në këtë grup ai përfshin edhe lokucione ndajfoljore që formohen me anë të *së* ose për *së*: *së largu, s'andejmi, së jashtmi, së brëndshmi etj.*(2) të kohës: *tashi / tashit, tashit për tashit, kur, kurrë, as ndo një herë, sot me natë (somenat), kurdoherë, shpejt, vonë, mënuarë, dëndurë, sakakjëra (imediataamente-menjëherë), natënë, ditënë, njënatëzaj etj.*(3) të sasisë dhe të krahasimit: *sa, shumë, më, më tepër, kurrgjë, asgjë, gjë, gjatsh, ditsh (qualcosa), një pakë, një tshikë, tsa, pakëzë, mjaft (abbastanza), po-thua, thujse, të-pakënë, kakjë, akjë (tanto), afëro (circa), aspak, fare, as fare.*(4) të pohimit, të dyshimit e të mohimit: *po, posi, si urdhëron, për sigur, vërtet, ndofta, mbase, vallë, pa dyshim, me hir, jo, s', nukë, as, fare, dot.*(5) të mënyrës: *kështù, ashtë, sikundrë, mirë, liksht, kekj (male), mikjësish, gënjeshtrazi, urtësisht, me të butë, rishtazi, kot, mbë kot, plotësisht, kollaj, gjithashtu (lo stesso).*(6) të pyetjes: *kur? pse? si, kysh? sa? sa kohë?* (7) të rregullit: *(për) së pari, së dyti...; më së fundi / mbë ndë funt (finalmente, in fine).* Leotti konstaton se “*shumica e ndajfoljeve të mënyrës në gjuhën shqipe formohen me prapashtesën -isht*”. P.sh.: verbërë > verbërisht, burrë > burrërisht.

Në të njëjtën mënyrë, Leotti i sheh të përfuara edhe ndajfoljet e tjera si *vllazërisht, varfërisht, etj.*(po aty).

**Emanuele Giordano** në *Gramatikë Arbëreshe* (2005), e përkufizon ndajfoljen si “*pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që perfeksionon ose kompletton kuptimin e një mbiemri, të një foljeje a të një ndajfoljeje tjetër*”. Ai ofron këta shembuj argumentues: *vëre veç* (mettilo –la da parte); *gjegj shumë e fol pak* (ascolta molto e parla poco); *miku ecën shpejt* (l'amico cammina troppo in fretta).

Giordano i analizon ndajfoljet sipas strukturës dhe mënyrës së formimit duke i ndarë në:

- ndajfolje të thjeshta (avverbi primitivi): *shumë, pak, afër, jashtë, mirë etj.*
- ndajfolje të prejardhura (avverbi derivati): *burrërisht < burr ; trimërisht < trim etj.*
- ndajfolje të përbëra (avverbi composti): *kudovënd (dappertutto) < kudo (dovunque) + vend (luogo)*

Kur i analizon sipas mënyrës së formimit, Giordano rendit tri mënyrat e formimit të ndajfoljeve:

- duke u shtuar emrave prapashtesat –*as, -azi, -isht, -thi, -thin: bårkazi, pjesërisht, fluturimthi, pùpthin.*

## Ndajfolja në gramatikat arbëreshe

2) duke ia bjerrë nyjen e paravënë mbiemrave të nyjshëm: *mirë, vërtetë, shtrëmbur*.

3) duke bashkuar dy pjesë të ligjëratës, qofshin këta emra, mbiemra ose ndajfolje: *këmbëngryq, duarlidhur, padashur, pickandóra (di peso), pickila (sulle gote)*.

Edhe lokucionet ndajfoljore Giordano i sheh të formuara, po ashtu, në tri mënyra:

a) duke përsëritur dy herë temën e njëjtë (të shumtën e herëve në shumës): *dora dora, këmba këmba, copa copa, dy e dy*. b) duke hyrë në mes parafjala për: *ditë për ditë*

c) duke paravënë parafjalët *mbë, me, nga, pa*: *mbë këmbë, më të mirë, nga dita, me pahir*.

Autori klasifikon këto lloje ndajfoljesh:

1) të pohimit: *ëh, ëhj, ë, ëj, po, ne, vë, uà, nji = po (it. sì)*

2) të mohimit: *jo, jore, jolla, jok, nuk, nëng, s', as, mos = jo (it. no)*

3) të dyshimit: *ndonse, thomse, ndoshta, mànu, ndorrina = ndoshta (it. forse)*

4) të kohës: *nani, njëmend (ora), sot (oggi), menatet (la mattina), menatë, nesër; pasnesër,dej; paradej (fra tre giorni); prëmë (ieri sera); sonde (questa sera), herët (un tempo); djë; pëstaj, pra; simbjët, sivjet; motmot, mot (l'anno prossimo); vjet; adhë (ancora); ditën, natën...*

5) të vendit: *këtu, aty, këtëje, atje, afër, largë, jashtë, përpara, prapa, përsipër, përposhë, poshtë, lartë, sipër, mbi, nën, mbrënda, kudo...*

6) të mënyrës: *mirë, lik, keq, dukur, ndryshe, drejt, prap, mbarë (completamente); veç, ndomos, nëmos (altrimenti), ndonjëherë; me, ndorrina, ndoshta*.

7) të sasisë: *shumë, pak, më, aq, kaq, sadó, sadokund (in qualche modo); sadopak (almeno)...*

Gjithashtu, i rëndësishëm është fakti që Giordano vë në pah edhe një veçori gramatikore të ndajfoljeve, e cila e paralelizon me mbiemrat: aftësinë për t'u përdorur në shkallë të ndryshme. Ato i klasifikon kështu:

a) pohore (positivo): *mirë* (bene); b) krahasore (comparative): *më mirë* (piu bene); sipërore (superlativo): *shumë më mirë* (molto meglio- benissimo).

Kundrejt tre autorëve që përmendëm, **Luis De Rosa** në *Elementi di grammatica albanese - Variante Arbëreshe del Molise* (2005) nuk e përkufizon ndajfoljen, por paraqet pesë ndajfolje, të cilat ai i quan themelore: *më, si, njëra, vetëm dhe pa* (f.82).

Gjithashtu, ai flet për mënyrat e përfutimit të ndajfoljeve dhe prejardhjen e tyre. Kështu, De Rosa klasifikon mënyrat e përfutimit të ndajfoljeve:

a) nga mbiemrat me rënie e nyjes së paravënë: *mirë, keq, bukur, drejt, etj.*

b) nga pjesoret e së shkuarës, të cilat bartin kuptimin e një rrethane situacionale: *haptë, shprishët, mbyllur, etj.*

c) me anë të formimit të fjalëve të përbëra: *duornkryq, këmbënkryq, grykëhaptë, etj.*

d) nga përsëritja e trajtave të shumës të pashquar: *copa-copa, thela-thela etj.*

e) nga parashtesa të formuara nga parafjalët për: *me, pa, nga: pë'ndën = sotto (poshtë), pë'sypër, për jashta, nga dita, më të mirë, pa ditur*.

Gjithashtu, De Rosa vë në pah praninë e vetëm një forme të ndajfoljes së mënyrës, asaj me prapashtesën -isht, në të folmet e tyre lokale, në krahasim me ndajfoljet me -as, -azi, -thi, -isht që njeh shqipja standarde (f.83). Ndajfoljet e formuara me -isht përdoren, siç thotë autori, vetëm për të shprehur tipin e gjuhës së kombësive të ndryshme: *arbër - arbërisht, lëti - lëtisht = in latino-italiano* (po aty).

De Rosa klasifikon këto lloje ndajfoljesh: (1) të pohimit: *ejë = si (po); fare, gjithsej (gjithsena)*; (2) të mohimit: *jo, pak fare, mosgjë*; (3) të dyshimit: *ndrose = forse (ndoshta), ndë = se (nëse)*; (4) të mënyrës: *ashtu, kështu, mirë, keq, lig, dalë = piano (ngadalë), shpejt*; (5) të kohës: *atëherë, sande = oggi (sot), prëm = stasera (sonte), ditën, natën, mesditët, të hënën, të martën etj.*; (6) të vendit: *ku, këtu, atje, këtëje, atje, sypër, ndën, lart, poshtë, brënda, jashtë, përrëzë (vicino), gjerë (lontano)*. (7) të sasisë: *pak, shumë, kaq, aq*. Lidhur me ndajfoljet "*afër= vicino*" e "*larg= lontano*", De Rosa thekson që, edhe pse të evidentuara në këtë gramatikë, nuk janë të pranishme në të folmet e tyre lokale (f.85)

Në fund, ajo që vlen të theksohet, krahas trajtimit dhe pasqyimit gramatikor të kësaj pjese të ligjëratës, është pikërisht kontributi i devotshëm që këta autorë synojnë të përçojnë në ruajtjen dhe trashëgiminë e gjuhës dhe të traditave arbëreshe të të rinjtë e sotëm dhe brezat që do të vijnë.

## Albanologjia në Poloni, vështrim i shkurt historik

Albanologjia, fushë relativisht e re e shkencës në Poloni tashmë ka një traditë dhe histori. Ky artikull i shkurtër është në lidhje me çështjen e albanologjisë polake.

**dr. Artur Karasiński, asistent**  
Universiteti i Nikolla Kopernikut në Torunj

Pararendës në fushën e kërkimit albanologjik në Poloni konsiderohet, me të drejtë, Profesor Waclaw Cimochoowski, gjuhëtar indoeuropeist dhe albanolog i shquar, puna e të cilit në etimologjinë e gjuhës shqipe janë të një rëndësie shumë të madhe për origjinën e gjuhës shqipe që rrjedh, siç pretendon Cimochoowski, nga gjuha e Ilirëve të lashtë.

Teza e konfirmuar nga analizat e Cimochoowskit u prit me entuzjazëm nga albanologët lokalë dhe tani është e zakonshme në mesin e shkencëtarëve dhe është trajtuar si një aksiomë. Në çdo rast, mohimi i pretendimi të tillë nuk ka qenë pranuar mirë edhe nga Shqiptarët e zakonshëm edhe nga albanologët shqiptarë.

Cimochoowski, edhe pse karriera e tij akademike ka filluar në Poznanj është jeta e tij të punës të përfshira me Torunj, më të merituarit për albanologjinë polake qytetin në Poloni qendrore. Nga 1954-1978 ai punoi në Universitetin e Nikola Kopernikut në Torunj. Ai kryesoi Departamentin e Gjuhësisë së Përgjithshme atje. Për arritjet e tij shkencore duhet të jetë një numër i veprave mbi origjinën dhe zhvillimin historik të gjuhës shqipe<sup>1</sup>.

Kështu, themelet e albanologjisë në Poloni kanë një themel mjaft të fortë. Për fat të keq, pas vdekjes së profesorit Cimochoowski ka pasur disa ndërprerje në interes të Shqipërisë dhe albanologjisë. Askush nuk ka vazhduar të drejtë kërkime dhe hulumtime të profesorit Cimochoowski. Edhe shumë e rëndësishme për albanologjinë polake është puna dhe botimet e Profesorit Włodzimierz Pająkowski (1934-1992), historian dhe afatgjatë drejtor i Ballkanistikës në Universitetin në Poznanj.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është krijimi i studimeve ballkanologjike në Universitetin e Nikola Kopernikut në vitin 2000. Themeluese dhe drejtoreshë ishte Prof. Irena Sawicka. Ndërsa Prof. Sawicka u kthye për të punuar në Akademi e Shkencave të Polonisë (në Varshavë) dhe nuk është më duke punuar në Torunj në kontributin edukativ, zhvillimin e saj për albanologjinë dhe ballkanologjinë në Poloni është themelore dhe të pamohueshme. Studimet Ballkanike në Universitetin e Nikola Kopernikut funksionon me sukses në këtë ditë, dhe edukon studentët e specialiteteve të ndryshme. Studentët mësojnë dy gjuhë ballkane në të njëjtën kohë. Tani në çdo vitin e parë hapen dy grupe: një shqiptaro-serbe dhe një kroato-bullgare. Mësimet e gjuhëve të huaja janë dhënë kryesisht nga native speakers. Sa i përket gjuhës shqipe deri më tani kanë punuar në Torunj tre mësues shqiptarë: Astrit Beqiraj, Çlirim Bidollari dhe Orges Bekteshi. Ky i fundit gjeti një shtëpi të dytë në Poloni dhe e sheh punën e tij si një mision për gati 10 vjet; në të tashmen i mëson studentët polake të albanistikës. Gjithashtu në Torunj punon specialist i letërsisë nga Shqipëria dr Rigels Halili. Studimet sipas procesit të Bolonjës janë në dy nivele dmth. tre-vjeçar program Bachelor dhe dy vjeçar program Master. Çdo vit vjen rreth 10 të diplomuarve me njohuri të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare. Disa prej tyre janë të lidhur me profesionin e punën e tyre të ardhshme si një përkthyesi, apo në industrinë e turizmit. Shënimi i veçantë është punësimi ciklik i të diplomuarve të Ballkanistikës (me njohuri të gjuhës shqipe) në punën e përkthyesit në misionet e Kontigjentit Polak Ushtarake në Kosovë si pjesë e misionit paqeruajtës të KFOR-it.

Një avantazh i rëndësishëm i Ballkanistikës në Torunj është që të mbajë modelet e studimeve filologjike, në mënyrë që studentët marrin një njohuri të plotë të kombit, historinë e saj, kulturën, gjuhën, letërsinë dhe artin. Me rëndësi të madhe është mundësia e studentëve tanë për të marrin pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë, i cili organizohet prej kohësh në këtë qytet. Falë organizatorëve të Seminarit, një grup të madh të studentëve polake prej Torunit çdo vit mësojnë praktikisht gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Në mënyrë që të theksojë dhe të nxjerrë në pah funksionimin e Ballkanistikës në Torunj, në dhjetor 2010, u

## Albanologjia në Poloni

organizua kryesisht nga prof. Irena Sawicka Konferenca Ndërkombëtare me rastin e 10-vjetorit të Ballkanistikës në Torunj. Pavarësisht dimrit jashtëzakonisht të ashpër gjatë kësaj periudhe, konferenca u ndoq nga shumë të famshëm ballkanologët dhe albanologët, duke përfshirë edhe prof. Helmut Schaller, prof. Aleksandër Rusakov, prof. Francesco Altimari dhe shumë figura të tjera të shquara të shkencës.

Duhet të theksohet se për disa kohë gjuha shqipe është mësuar në Poloni edhe në Universitetin në Poznanj (Adam Mickiewicz University). Atje ka një lektorat në kuadër të studimeve quajtur edhe Ballkanistik. Këto studime, megjithatë, janë fokusuar më shumë në kulturën e rajonit dhe i kushtojnë më pak vëmendje çështjeve të filologjisë.

Aktualisht, në Poloni punon një numër i madh studiuesve dhe hulumtuesve, të cilët merren kryesisht me çështjet shqiptare. Ata i japin hulumtimet e tyre në gjuhën, letërsinë por edhe në historinë dhe shkencat politike. Vlen të përmendet doktori i shkencave historike Tadeusz Czekalski, shkencëtari politik Adam Balcer dhe shumë të tjerë. Për shumë vite të tëra zonja Dorota Horodyska sjell letërsinë shqiptare në tregun e librave në Poloni. Çështja e zhvillimit të albanistikës në Poloni është përshkruar në detaje në publikimin redaktuar nga profesoresha Irena Sawicka me titullin *Albanistyka Polska*<sup>2</sup>, për të cilën unë i referohem dhe ju inkurajoj.

1) Pjesë e punës u botua në vëllimin **Waclaw Cimochoowski**. *Studia Albanica*, Torunj 2001, redaktuar nga profesoresha Irena Sawicka dhe profesor Leszek Bednarczuk. Në këtë vëllim janë mbledhur punat kryesore e profesorit Cimochoowski në fushën e gramatikës historike, problemet e vendlindjes dhe origjinës së gjuhës shqipe, dhe disa studime etimologjike.

2) **Sawicka Irena**, *Albanistyka Polska*, Botimi i Universitetit të Nikola Kopernikut, Torunj 2007

## Vëllezërit Gjergji, meshtarë

Në një atmosferë të gëzueshme u festua, në Detroit, 40 Vjetori i shugurimit meshtar të Don Ndue Gjergjit dhe Don Lush Gjergjit, në sallën e kishës së Zojës Pajtores. **NDER DHE RESPEKT PËRJETË PËR KËTA FIGURA TË SHQUARA TË KISHËS DHE TË KOMBIT**. Përshendetja e plotë në hapje të meshës shenjtë për nderim të Don Ndout dhe Don Lushit:

“I nderuar, Don Ndue Gjergji, I nderuari Don Lush Gjergji, të nderuar meshtarë dhe të ftuar nderi, Të nderuar vëllezër dhe motra besimtare. Sot për Kishën tonë, për komunitetin dhe sidomos për famulltarët Don Ndou dhe Don Lushi është një ditë e veçantë, sot ata kremtojnë 40 vjetorin e shugurimit meshtarë si dhe të meshës së tyre të parë. Vëllezër dhe motra, nuk është rastësi, që historia e Shqipërisë, mbas Gjergj Kastriotit, në të gjitha stacionet e kryesore të ekzistencës së saj, identifikohet me figura të shquara kishtarë, duke filluar nga Buzuku tek Budi dhe Bogdani, Mjeda dhe Fishta, e deri tek shenjteresha Nëna Tereze. Nga ky këndvështrim, në këtë rrjedhe të ndritur të historisë shqiptare të shekullit të 20 dhe 21, veçojmë edhe veprën dhe jetën e Don Lush Gjergjit dhe Don Ndue Gjergjit. Këta dy njerëz të mëdhenj, të dalë nga një familje të pastër dhe fisnike shqiptare, nën dritën e Krishtit, gjithë jetën dhe veprën e tyre ja kanë kushtuar Zotit dhe njëzimit.

### Dy fjalë për Don Lushin:

Don Lush Gjergji u lind në Stubëll të Epërme të Vitisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Gjimnazin klasik e kreu në Dubrovnik, magistraturën në filozofi në Romë, si dhe ka diplomuar në teologji dhe sociologji. Në vitin 1975 në universitetin shtetëror të Romës ka fituar titullin Doktor i Shkencave në psikologji. Është shuguruar meshtar në Binçë më 11 gusht 1973, ndërsa Meshën e Parë e ka kremtuar në Stubëll më 12 gusht 1973. Qysh mbas shugurimit Dr. don Lush Gjergji ka sherbyer pa ndërprerje në Kosovë, pikërisht në Ferizaj, në Binçë, në Prizren, dhe sot është vikar i

përgjithshëm i Ipeshkvisë së Kosovës, dhe shërben në katedralën e re Nënë Tereza në Prishtinë. Vite me rradhë ka qenë redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetaro-kulturore i shtëpisë botuese “Drita” me seli në Ferizaj. Është njohës i gjuhës së vjetër latine, i gjuhës së vjetër greke, i gjuhës italiane, gjermane, frenge, angleze dhe i gjuhëve sllave që fliten në Ballkan. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtar i Gazetarëve dhe Publicistëve Katolik të Evropës dhe anëtar i Akademisë Evropiane. Don Lush Gjergji është njëri nga intelektualët tonë më të njohur në të gjitha viset shqiptare, dhe në diasporë. Deri më tash ka



## 40 vjetori i meshtarisë së Don Ndue Gjergjit dhe Don Lush Gjergjit

kontribuar në disa fusha të jetës e të dijes. Përveç që është çmuar në misionin meshtarak, për të cilën edhe është shkolluar, aktiviteti i tij ka qenë i dalluar sidomos në misionin humanitar e fisnik, në pajtimin e gjaqeve, e atë të peshës së fjalës së gjallë, që e bëri të dalluar me aftësitë oratoriale e njerëzore, e cila i prek majat e ndërgjegjës së njerëzimit. Po ashtu Don Lush Gjergji është edhe një shkrimtar the publicist i njohur. Deri më tani ka botuar 60 libra, shumica prej të cilave janë përkthyer në më se 35 gjuhë të botës. Don Lush Gjergji është studiuesi më i mirfilltë i veprës dhe jetës së Nënë Terezës, nga e cila ai u frymëzua qysh nga takimi i tyre i parë në vitin 1968. Jeta, vepra dhe mendimi i Don Lush Gjergjit është i lidhur ngushtë me figurën e Nënë Terezës. Të flasësh për Nënë Terezën, nuk mund të rrish pa folur për Don Lushin, dhe anasjelltas. Prandaj 13 nga librat e tij i kushtohen shenjtëreshes Nënë Tereza, te cilën Don Lushi e quan simbol i rilindjes, depërtimit dhe shpresës. Të gjithë jetën deri më sot, Don Lushi ia kushtoi në shërbim ndaj Zotit, Kishës dhe Njerëzimit dhe thelbi i veprës së tij është siç ai thotë: “E vërteta në dashuri dhe për dashuri!”.

### Dy fjalë për Don Ndoun:

Don Ndue Gjergji lindi në Stubullën e Epërme. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Është diplomuar në Romë në degën e teologjisë në vitin 1973. Është shuguruar meshtar në Komunën e Binçës më 11 gusht 1973, nga i ndjeri ipeshkëv Mons. Nikë Prela. Pas shugurimit meshtar, Don Ndou ka shërbyer, me përkushtim e dashuri, në famullinë e Binçës vite me radhë, nga viti 1975 – 1993. Famulli të cilën më pas e drejton Don Lushi deri në 2007. Në vitin 1997 Don Ndue Gjergji emërohet ambasador i Kishës Shqiptare të Kosovës në SHBA, pikërisht në Kishën tonë të Zojës Pajtores, e cila për 20 vite me rradhë udhëhoq nga famullitari i përndershëm, i ndjeri Ndrekë Ndrevashaj. Qysh nga ajo kohë Kisha jonë nën drejtimin e don Ndue Gjergjit ka njohur rritje të vazhdueshme, si në aspektin fetar e shpirtëror të predikimit të fjalës së Zotit, por edhe në aspektin e jetës shoqërore, Letraro-artistike, e atdhetare të komunitetit shqiptar këtu në Michigan. Përmend këtu, traditën e festivaleve të përvitshme, kremtimit të vazhdueshëm të festave kombëtare shqiptare, promovimeve të veprave të shkrimtarëve, fejesa, dasme dhe hatrave. Tek personi i Don Ndue Gjergjit shohim njeriun e mirë, të mençur, i paqtë, stoik dhe qëndrestar i së drejtës dhe të vertetës njerëzore. Si njeri publik, Don Ndou lehtësisht mund ta quajmë strateg i paqes në mes shqiptarëve të përmbledhur në kulte të ndryshme fetare, shoqata dhe parti.

Si meritë e punës organizuese se Don Ndout dhe përgjigjes në kohë të komunitetit, u bë e mundur sigurimi i këtij ambienti të ri kishtar që kemi sot. Në kulmin e aktivitetit të tij, në shtator të këtij viti, për herë të parë kishën tonë të Zojës Pajtores e viziton një President i Shqipërisë, ku me të njejtin rast Kisha jonë vlerësohet me titullin e lartë “Nderi i Kombit”. Dhe me meritë të plotë nderin tonë dhe nderin i Kombit ia përcjellim famullitarit tonë Don Ndue Gjergji. Tek këta dy vëllezër, shërbëtorë të Krishtit dhe prinjës të komunitetit, ne shohim dashurinë deri në përkushtim, përkushtimin deri në lodhje, lodhjen deri në dhimbje, dhimbjen deri në përvujtni, përvujtninë deri në dashuri. Në fytyrat e këtyre meshtarëve, ne shohim shembëlltoren e Jezu Krishtit. Prandaj nga ky shembull, të prirur nga virtyti i dashurisë, ta duam dhe ndihmojmë shoqishoin, në mënyrë që të shohim dhe të gjejmë tek njeri tjetri shëmbëlltoren e Jezu Krishtit. Don Ndue Gjergji e Don Lush Gjergji, në emër të Këshillit të kësaj kisha dhe të anetarëve të kësaj Famullie, me zemër dhe me gojën plot, ju themi: Faleminderit. Zoti kjoftë me ju në çdo ditë të jetës tuaj! Krishti ua shndritë, ua bafte të bardhë dhe të mbarë rrugën tuaj në shërbim të Kishës dhe njerëzimit. Zoti i bekoftë nanën dhe babën që ju lindën dhe ju rritën, Zoti ju bekoftë juve.

(Nga **Valentin Lumaj**, Kisha Zoja Pajtores, Detroit / Michigan, 01 Dhjetor 2013)

### Shënimi bibliografik mbi don Lush Gjergjin

**Don Lush Gjergji**, *Të ftuar dhe të dërguar*, Shtëpia Botuese Drita, Prizren 2012;

**Don Lush Gjergji**, *Dashuria që nuk vdes - Të mëdhenjtë e shekullit XX*, Shtëpia Botuese Drita, Prizren 2013;

**Frook Kristaj**, *Arti i dialogut (Intervista me dr. don Lush Gjergjin)*, Shtëpia Botuese Drita, Prishtinë 2013;

## Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Simbjet, te Seminari XXXII Ndërkombëtar i Prishtinës, i drejtuar për të tretën herë ka dr.prof.asoc.Bardh Rugova, Arbëreshët që mbajtin referata ose kumtesa qenë pakë: *Zef Chiaramonte* (Pozita juridiko-shoqërore e kolonive arbëreshe nëpër shekuj në Shqipëri), *Emilia Conforti* (Rreth natyrës dhe statusit të sonantes [j] në shqip, krahasuar me italishten), *Giovanni Belluscio / Giuseppina Turano* (Ku fshihet identiteti në letërsi?).

Bashkëpunorët shqiptarë (të vjetër dhe të rinj) të “Jetës Arbëreshe”, që mbajtin Ligjërata, Referata ose Kumtesa te ky Seminar, qenë: *Imri Badallaj* (Kontributi i Claus Haeblerit në studimin e të folmeve arbërore të Greqisë), *Rexhep Ismajli* (Diskutime për prejardhjen e gjuhës shqipe), *Merita Bruçi* (Vendi i munguar i F.A.Santorit në letërsinë shqipe), *Aleksandër Novik* (Leksiku i mitologjisë: hulumtimet në terren ndër Shqiptarët e Ukrainës), *Bardh Rugova* (Imazhi i shqiptarëve në gazetën New York Times në kohën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë), *Merita Hysa* (Shtresëzime konceptuale në Albanian Phonology të G.Bevington), *Orjeta Baja* (Kristian Gyt për gjuhën shqipe), *Majlinda Bregasi* (Kontributi i Leonardo Maria Savoia-s për albanologjinë, në gjysmën e dytë të shelullit XX), *Rrezarta Draçini* (Botime të albanologëve shqiptarë në “Studime krahasuese për shqipen” të Eric Hamp)<sup>1</sup>, *Edmond Çali* (Identiteti i një shkrimtari nga shqyrtimi i variantistikës në romanet e tij: Jakov Xoxa, Juga e bardhë 1971, 1980, 1983), *Hamit Xhaferi/Nerita Xhaferi* (Individi dhe identiteti kombëtar në letërsinë shqipe). Mbi Letërsinë Arbëreshe mbajti një kumtesë *Mark Marku* (Vetëpërceptimi dhe identiteti në letërsinë e arbëreshëve të Italisë). E Drejtori i J.A., *Agostino Giordano*, foli mbi “Arbëreshët dhe shkrimi letrar”.

**1) Rrezarta Draçini, Përfitim i shqipes përmes dialektit dhe standardit** (monografi), Fiorentia, Shkodër 2013

çështje të etnolinguistikës.), E.Çali (Botimet “Novellistica Italo-albanese” të Institutit të Studimeve Shqiptare në Universitetin “La Sapienza” të Romës), T.Osmani (Historia e shkrimit të Shqipes në pendën e studuesve shqiptarë.), Meri Hysa (Elemente të grafematikës në gjuhësinë shqiptare), M. Priku (100 vjet studime për shqipen nga filologët italianë), M.Bregasi, at Viktor Dëmaj (Kontributi françeskan në gjuhësinë shqiptare gjatë shekullit XX). Ndërsa, tek vëllimi 31/2, gjëmi botuar këto kumtesa: H.Xhaferi (Zhvillimet e prozës shqipe pas periudhës së Pavarësisë), K.Kodra (Veçori të shkencës letrare të viteve të fundit).

**Buzëdhelprri / Agostino Giordano, Telet e zëmrës,** poezi, Faik Konica, Prishtina 2013

Kjo është e katërta përmbledhje poezish të Buzëdhelprit. E botuar në Kosovë. Të tjerat kishin parë dritën në Arbëri (1971), në Maqedoni (1976) e në Shqipëri (1997). Kjo, si ajo e botuar në Tiranë, përmban edhe 10 poezi të zgjedhura nga vëllimet e mëparshëm. 55 janë poezitë e reja: më të shumtat edhe të botuara, gjatë viteve, mbi ndryshe revista ose gazeta arbo-shqiptare. Përgatiti për botim, me zell, prof. Imri Badallaj; redaktoi bukur Nazmi Rrahmani. E Autori përpunoi tekste sa më arbërisht munda.

**Stamile Carmine, Vjeshe popullore** (Canti Popolari), raccolta del lessico arbëresh del Comune di Cerzeto, (a cura dell'Amministrazione Comunale di Cerzeto (Cs), vol.II, Edizioni Orizzonti Meridionali, Cosenza 2013

Mjeshtri Karminuci Stamile ka Shën Japku, - bashkë me Roza Bruno ka Frasnita, me Gjergj Maranin ka Mbuzati, me Tumazinën Guarino ka Kuntisa, me Ernest Toçin ka Shën Murtiri etj... - i mësoi djemvet arbëreshë të djovasjin e të shkruajnë arbërisht. Për dhjetra vjet. Ki është i diji libër që ki mjeshtër skollje i dhuron Bashkisë s'tij, Qanës, dhe Shën Japkut, katundit tij ku u le e mësoi. Një mbledhje vjershesh popullore, malli e vreri, që autori, njeri pas jetrit, boton ashtu si zënë fill, sikur t'ish një Fjalor. Jo për gjë, ki libër është një Mbledhje Fjalësh. Po Bashkia e Qanës turrent, për të Folmen e saj Arbëreshe, i gjën e i spëndon.

**Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe kulturën shqiptare, Materialet e Punimevet të Seminarit XXX, Prishtinë 2011/ e të Seminarit XXXI, Prishtinë 2012**

Tek vëllimi 30/2 i Seminarit 2011, mbi Botën Arbëreshe gjëmi të botuar vet një kumtesë autorësh arbëreshë: *Giordano Agostino*, “Dhjetëvjetori i Jetës Arbëreshe”; po janë edhe të tjera kumtesa mbi Botën Arbëreshe, të këtyre studuesve shqiptarë: *Edmond Çali* (mbi Letërsinë Arbëreshe), *Selim Sylejmani* (mbi Serembe), *Agim Vinca* (mbi Dushko Vetmo), *Blerina Suta* (mbi Zef Schirò Di Maggio), *Vëbi Bexheti* (Mbi Poezinë Arbëreshe), *Marjela Progni-Peci* (mbi Jeronim De Rada).

Tek vëllimi 31/1 i Seminarit 2012, mbi “Botën Arbëreshe” s'gjëmi botuar mosnjë kumtesë autorësh arbëreshë; po gjëmi shkrime të këtyre Bashkëpunorëve tanë: *A.Vinca* (Mihal Hanxhari, një poet ndryshe), *A.Novik* (Ekspedita shkencore te Shqiptarët e Ukrainës:



**Le donne danzanti al suono balcano e tra i passi arabi****L'Albania è un racconto****Pierfranco Bruni**

ka Sullarënxa (Cs)

Nell'alba tarda l'auto da Tirana va verso Scutari. Ci sono giochi di ombre e le ombre sono dei chiaroscuri.

L'Albania è un racconto!

Tirana.

Non un ricordo. Ma un presente nella sua presenza nella mia vita.

Una città che porto nei miei viaggi. È l'Adriatico che dialoga con i Mediterranei. È la danza balcana che racconta la storia della mia terra tra le favole di Scanderbeg e il tempo spaginato nei giorni che toccano le avventure di mio padre. Più volte sono stato a Tirana.

Scutari. Un andare tra le malinconie e i battiti d'anima.

Le Moschee, dove ho pregato, hanno la parola orante di un Dio che sempre illumina.

Quei volti, quelle strade. I vicoli sono intrecci nelle parole e nei linguaggi tra un albanese che è ricordo di antico con gli accenti del Sud d'Italia.

Nel mio Sud c'è anche la mia Albania. Nella mia Albania dei viaggi lasciati sempre incompiuti ci sono pezzi di radici. Ascolto le musiche. Pur nelle notti e nel freddo tagliato dal sole quell'Oriente mi penetra. Ho foto incallite di anni trascorsi tra spazi di incontri e di conferenze. Scutari, non molte lune fa, mi ha accolto con la simpatia e il sorriso tirato dall'avventura albanese.

Viverci potrebbe essere un'abitudine. Ma l'abitudine si spezza.

Viverci è sempre lasciare tra le strade un pezzo della propria vita.

I ricordi mi coltivano e raccogliere le case rotte e i nuovi quartieri di Tirana è un gioco in un immaginario che non mi abbandona.

Ho sempre saputo che tra i fili radicanti delle mie radici ci sono voci d'Albania. Sin dalla mia infanzia vissuta in un paese della Calabria, che ha ospitato i primi albanesi arrivati in Italia, ho intrecciato malinconie.

Dall'oblò dei miei passi recitati, allora, guardavo sulla geografia dei mondi dove fosse l'Albania. Poi mi sono reso conto che nel vecchio di Tirana, un racconto mio di secoli fa, vivevano le metafore del mio esistere.

Non so perché scrissi, secoli fa, un racconto

intitolandolo proprio "Il vecchio di Tirana".

Poi ho scoperto le mie vie. Sono arrivato agli orizzonti in cui l'Adriatico intreccia i miei Mediterranei e l'Albania è il centro dei miei destini. Poi ho camminato tra le strade dell'Albania e lì in quelle danze dove le donne sono incantesimo d'Oriente nell'Occidente ho intrecciato i sentieri dell'anima con gli sguardi mai assenti.

I colori del giallo e del rosso dei vestiti danzanti delle donne albanesi sono un girotondo tra le mie immagini. È come se raccogliessero giorni di festa e quegli occhi di mare tra il verde l'azzurro e il celeste sono un camminamento tra le pieghe delle nostalgie. La nostalgia! Non so se sono io ad accompagnare la nostalgia o se è la nostalgia a seguire il viso di quelle donne che hanno la pelle balcana e il canto che ha rimandi arabi.

Il fascino del mistero non ha il tempo della ragione. Ma io vivo del mistero nel fascino dell'incanto. E dopo la realtà il mistero dell'Albania è un incantesimo tra le mie parole.

Le mie parole hanno la nostalgia? O la nostalgia ha le mie parole incatenate nei ricordi di un'Albania che porto nel cuore?

Ho sempre cercato di ritornare nell'Albania delle parole spezzate e dei linguaggi ritrovati. È un canto che recita. È un canto che disegna destini.

Porto l'Albania tra i silenzi e le voci.

Porto l'Albania tra le mie radici e le memorie.

Avrò altri appuntamenti. Altri appuntamenti mi aspettano ancora nel sole che taglia il vento tra Tirana e Scutari.

Ci sono suoni balcani e passi arabi nella mia Albania e tra le donne danzanti che hanno il sogno nell'alchimia dell'incanto.

C'è sempre un'alchimia che si lega ai viaggi. Io, che tanto ho viaggiato, non ho mai frammentato il mosaico dei giorni.

L'Albania è un mosaico. Tra i miei giorni. E le danze non smettono di vivere nel ritmo dei miei silenzi.

È il tardo meriggio.

L'auto da Scutari verso Tirana.

Non ci sono più ombre. Roseo, rossiccio, amaranto.

E poi il crepuscolo.